



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 21.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Tryezë konsultimi publik për projektligjin “Për noterinë” me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë, me anëtarët e Këshillit Kombëtar të Noterisë, me kryetarët e dhomave të noterëve, me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe me ekspertë ndërkombëtarë e vendas të misionit ndërkombëtar EURALIUS.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Katrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Periand Teta - Drejtor i Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Agnes Bernhard – shefe e misionit EURALIUS

Tedi Dobi – ekspert vendas i misionit EURALIUS

Mimoza Sadushi - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Fatmir Lacey - përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtar i Këshillit Kombëtar

Fitnete Lika - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Vasil Martini - përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtarë i Këshillit Kombëtar

Violeta Sulka - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Elona Saliq - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Gentiana Brati - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Enkelejda Hoxha - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Albana Hoti - përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtare e Këshillit Kombëtar

Sabri Kurtaj - përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtar i Këshillit Kombëtar

Arben Kopliku - përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtar i Këshillit Kombëtar

Ardjan Karroqe - përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe anëtar i Këshillit Kombëtar

Artan Treska - kryetar i Dhomës së Noterisë Tiranë

Gelanda Shkurtaj - anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë

Sonila Bejtja - anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë

Hysni Ahmetaj - anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë

Stavri Ruvina - kryetar i Dhomës së Noterisë Korçë

Klement Radovani - kryetar i Dhomës së Noterisë Shkodër

Ermira Agaraj - kryetare e Dhomës së Noterisë Durrës

Vezire Dushi - kryetare e Dhomës së Noterisë Vlorë

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka organizuar këtë tryezë të konsultimit publik për projektligjin “Për noterinë”. Projektligji “Për noterinë” është pjesë e paketës së dytë prej 27 ligjesh të reformës në drejtësi, që pritet të kalojë në parlament së bashku me projektligjin “Për shërbimin përmbartimor privat”, me projektligjin “Për Policinë Gjyqësore” dhe me strategjinë e edukimit ligjor, duke përmbyllur kështu të gjithë paketën e reformës në drejtësi, që ashtu siç e dini, me vendim të Kuvendit, nga Komisioni i Posaçëm i Reformës në Drejtësi, i ka kaluar Komisionit të Ligjeve. Ky projektligj bën gati 3 vjet që është në diskutim, fillimisht në komisionin e posaçëm dhe tashmë në Komisionin e Ligjeve.

Në fakt, para se të bëj prezantimin e të ftuarve në këtë tryezë të konsultimit publik, është me rëndësi për komunitetin e noterëve, por edhe për opinionin publik, të sjell në vëmendjen tuaj, që kjo nuk është tryeza e parë e konsultimit publik. Këtu shpreh keqardhjen për rolin e të paditurit që gjatë kësaj kohe të komunikimit të komisionit me të gjithë noterët e Shqipërisë për të sjellë komente dhe mendime në lidhje me ligjin, kanë luajtur rolin e të paditurit, a thua se ky projektligj po bëhet në mënyrë të fshehtë dhe po llobohet nga interesa të caktuara. Jo, një tryezë e një formati shumë më të madh se kaq është zhvilluar në datën 19.01.2017, e regjistruar dhe me minuta, dhe, fatmirësisht, ju jeni përfaqësuar jo vetëm nga drejtuesit e dhomave, por plot 64 noterë, të shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë marrë pjesë në diskutime dhe debate aktive, qoftë me prezencën fizike, por edhe dhjetëra e dhjetëra të tjerë, që kanë sjellë komente me shkrim pas organizimit të kësaj tryeze. Kjo është njëra nga tryezat e konsultimit publik, pa llogaritur diskutimet që janë bërë në grupin e punës mes relatores, Ministrisë së Drejtësisë, misionit EURALIUS-it, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, por edhe me noterë të caktuar, të cilat kanë pasur interes të drejtpërdrejtë të përfshihen në diskutimin e këtij projektligji.

Gjatë këtyre ditëve të komunikimit me ju dua të falënderoj të gjithë ata noterë që janë fokusuar me komentet e tyre realisht në thelbin e këtij projektligji, që është akti noterial. Pra, shërbimet ligjore që do të duhet të marrin qytetarët e Republikës së Shqipërisë nga ky projektligj që ne do të miratojmë. Mos harroni, ju jeni vula e shtetit në territor. Shërbimi ligjor që shteti u jep qytetarëve nëpërmjet jush, është përgjegjësi direkte jona. Më vjen keq që disa nga noterët që kanë sjellë komentet kanë paragjykuar punën e këtij komisioni, punën titanike

të zhvilluar nga deputetët, nga relatorja, nga misoni EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë, që, fatkeqësisht, në këndvështrimin tim, nuk e di a e meritojnë apo jo ta kenë vulën e shtetit në territor, sepse të thuash se thelbi i këtij projektligji është noteri, është fatalitet. Si mund të jetë thelbi i këtij projektligji noteri?! Thelbi i këtij projektligji është interesi publik, është shërbimi ndaj qytetarëve. Noteri, për aftësitë që ka, për shkollimin që ka, për formimin që ka, është licencuar nga shteti për ta ofruar në cilësinë më të mirë këtë shërbim publik për qytetarët. Për ne thelbi i këtij projektligji është si mund të përmirësohet cilësia e këtij shërbimi për ato shërbime që ju me ligj ua ofroni qytetarëve.

Sigurisht, Ministria e Drejtësisë është përgjegjësie për të gjitha shërbimet e lira në Republikën e Shqipërisë. Patjetër që e inkurajojmë autonominë e Dhomës Kombëtare të Noterisë, por me sa po shikoj ju, 470 noterë që ka Shqipëria e paskeni me organizimin tuaj çështjen, nuk e keni me shërbimin që duhet t'i ofrohet publikut. Publiku nga ky projektligj pret: aktin noterial të detajuar mirë në ligj, cilësinë e shërbimit, dhënien fund të asaj historie, që noterët me çantë në dorë shkojnë nëpër zyrat e bizneseve për të përpiluar aktin noterial dhe veprimet noteriale. Pra pret dhënien fund, që e merr licencën për të punuar në Shkodër dhe mbi 60-70 noterë rrinë në Tiranë, ia kanë humbur rëndësinë këtij profesioni. Nuk është shqetësimi ynë se si do të organizoheni ju, do të ketë asamble kombëtare, do të ketë këshill drejtues, do të ketë 6 dhoma vendore apo do të ketë 5 dhoma vendore, këto janë çështje të brendshme tuajat. Ne e inkurajojmë autonominë, por jo rrëmujën në kurriz të cilësisë së shërbimit.

Gjatë këtyre ditëve që ne e kemi shpërndarë këtë projektligj, që sigurisht nuk është përfundimtar, absolutisht, sepse ndryshe nuk do ta kishim organizuar këtë tryezë, kam parë një interesim të jashtëzakonshëm të kolegëve të mi deputetë jo vetëm të Komisionit të Ligjeve, sepse deputetët e Komisionit të Ligjeve janë juristë dhe e kanë të qartë rëndësinë e një projektligji, siç është noteria, por edhe të deputetëve të të gjitha krahëve politikë, interes i jashtëzakonshëm për ligjin “Për noterinë”. Pse është ky interes?! Ju kujtoni se duke lobuar deputetë të caktuar, mund të influenconi se ky projektligj të miratohet për të plotësuar tekat e noterëve apo dhomave të caktuara të noterisë. Absolutisht, jo! Ndaj, ky bashkëbisedim që kemi sot duhet të jetë një bashkëbisedim i hapur, me një minutash kohe të përcaktuar, duhet të jetë një bashkëbisedim që kryetarët e dhomave vendore, nëse kanë ardhur në emër të dhomave vendore të shprehen me mikrofon, “po, përfaqësojmë dhomat vendore, dhe sjellim mendimin e të gjithë noterëve që kemi në dhomë”, ose nëse përfaqësojnë vetveten të thonë: “shpreh mendimin tim personal në këtë tryezë të konsultimit publik”. Por mos harroni se thelbi i debatit do të jetë shërbimi i noterisë në Republikën e Shqipërisë, si funksion i deleguar i shtetit, si vulë

e shtetit shqiptar në territor, akti noterial, veprimet noteriale dhe cilësia e shërbimit për qytetarët, se si do ta organizoni ju më pas, është në interesin tuaj, jo tonin.

Sigurisht, ka mendime dhe komente të ndryshme, por në finale vendimmarrja do të jetë politike, sepse përgjegjësia për procesin e ligjbërjes është e kësaj maxhorance që qeverisë Shqipërinë. Në fund fare është vullneti i sovranit që do t'i hapë rrugë këtij projektligji. Por mos harroni se ne asistohemi në këtë proces të ligjbërës së reformës së drejtësisë nga misioni i EURALIUS-it. Në fund i gjithë procesi i ligjbërjes është në një fazë të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian. Pra, ne nuk mund të pretendojmë të shkojmë në BE me një projektligj që na çon në krahun e kundërt. Këto ditë kam dëgjuar pa fund komente dhe vetëm këtu i bie që patjetër djali i marangozit duhet të bëhet marangoz dhe djali i këpucarit, duhet të bëhet këpucar ai ndoshta nuk di fare. Sigurisht, është çështje që duhet diskutuar edhe kjo.

Të nderuar noterë, në këtë tryezë të konsultimit publik kemi përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë, anëtarët e Këshillit kombëtar, kryetarët e dhomave vendore të noterisë, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, kemi ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas të misionit ndërkombëtar EURALIUS, gjithashtu kemi prezentë shefen e misionit të EURALIUS-it.

Të ftuar nga Ministria e Drejtësisë kemi zotin Toni Gogu, zëvendësministër i Drejtësisë, që ishte prezent, por ndoshta do t'i rikthehet përsëri tryezës së konsultimit, zonja Katrin Treska, drejtoreshë e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë dhe zoti Periand Teta, Drejtor i Hartimit të Legjislacionit.

Nga misioni i EURALIUS-it kemi zonjën Agnes Bernhard, shefe e misionit, dhe zoti Tedi Dobi, ekspert vendas.

Nga Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar janë prezentë: zonja Mimoza Sadushi, zoti Fatmir Laçej, zonja Fitnete Lika, zoti Vasil Martini, zonja Violeta Sulkaj, zonja Elona Saliaj, zonja Gentiana Brati, zonja Enkelejda Hoxha, zonja Albana Hoti, zoti Sabri Kurtaj, zoti Arben Kopliku dhe zoti Ardjan Karroqe.

Janë prezentë kryetarët e dhomave vendore: zoti Artan Treska, kryetar i Dhomës së Noterisë Tiranë, por nga Dhoma e Noterisë Tiranë kanë ardhur edhe disa noterë: zonja Gelandina Shkurtaj, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, zonja Sonila Bejtja, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë dhe Hysni Ahmetaj, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë; zoti Stavri Ruvina, kryetar i Dhomës së Noterisë Korçë, zoti Klement Radovani, kryetar i Dhomës së Noterisë Shkodër, dhe zonja Ermira Agaraj, kryetare e Dhomës së Noterisë Durrës.

Natyrisht, është i mirëpritur edhe çdo noter tjetër që sot është prezent në këtë sallë. Këtu kam pothuajse të gjithë kolegët e mi të Komisionit të Ligjeve, kam relatoren e këtij

projektligji zonjën Hysi, së bashku edhe me nismëtarët e projektligjit. Për shkak se kjo është një tavolinë shumë e zgjeruar, them që secili të japë qëndrimin dhe mendimin e tij brenda një kohe të përcaktuar. Pastaj të gjitha opinionet, komentet dhe diskutimet tuaja do të regjistrohen dhe, natyrisht, do të zbardhen dhe do t'i vihet në dispozicion grupit të punës që po punon me ligjin "Për noterinë". Po ashtu, të gjitha komentet që kanë ardhur këto ditë, janë të reflektuar në një material në një tabelë, që e kanë në dorë kolegët e mi deputetë, dhe pas kësaj tryeze të konsultimit publik do të ketë një kolaudim përfundimtar të projektligjit mes Komisionit të Ligjeve, Ministrisë së Drejtësisë, misionit EURALIUS dhe organeve drejtuese të Dhomës, nëse ju vazhdoni ta njihni njëri-tjetrin me këtë organizim që keni Dhomë Kombëtare dhe Dhomë Vendore. Nëse nuk e njihni njëri-tjetrin për këtë mënyrë organizimi që keni, përsëri këtë mund të na e thoni, dhe ne e marrim në konsideratë gjatë procesit të konsolidimit të ligjit, por të jeni të sigurt: ligji do të kalojë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Janë tri seanca deri në mbylljen e këtij sesioni parlamentar, 3 dhjetor, 13 dhjetor dhe 20 dhjetor në njërin nga këto tri data ky ligj, pasi të marrë edhe bekimin e deputetëve të Komisionit të Ligjeve, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të misionit të EURALIUS-it, sigurisht pret votën e deputetëve në parlament.

Edhe një herë faleminderit për prezencën, shpresoj të jetë një tryezë shumë frytdhënëse!

Para se ta fillojmë debatin, dua t'ia jap fjalën relatore së projektligjit për të filluar diskutimin, debatin dhe për të ndjekur rendin e këtyre diskutimeve.

Zonja Hysi, fjala është për ju, por, ju lutem, shkurt, sepse sot jemi për të dëgjuar këta.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar noterë,

Në vijim të asaj që tha kryetari i komisionit, për transparencë, dua të bëj me dije se të gjitha komentet dhe sugjerimet e ardhura në adresën e komisionit janë marrë në konsideratë për t'u shqyrtuar në vijim, por nuk janë diskutuar ende, pasi ne presim të dëgjojmë edhe mendimin tuaj. Ndërkohë, në trajtimin e propozimeve të ardhura, qoftë me *email* apo me shkresë zyrtare, kemi pasur rregullat e deontologjisë së organizatës së noterisë dhe modelin standard se si duhet të funksionojë Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Dhoma Vendore e Noterisë në një vend që pretendon të jetë vend i Bashkimit Europian. Nëse dikush prej jush nuk e ka modelin standard të një kodi të noterëve ose të ligjit "Për noterinë", ne mund t'ua vëmë në dispozicion, është në gjuhën angleze, por po ju garantoj se të gjitha standardet e panegociushme të këtij kodi, të cilat i kërkon BE-ja, ne i kemi marrë në konsideratë.

Koha ka qenë shumë e shkurtër, dhe të them të drejtën një pjesë e noterëve, në kundërshtim me rregullat e komunikimit në Kuvend kanë adresuar *email-e* personale, të cilat

ne nuk na lejohen. Kodi i Sjelljes së Deputetëve nuk lejon lobizmin dhe grupet lobiste, sepse komunikimi duhet të jetë nëpërmjet protokollit të Kuvendit të Shqipërisë, jo në adresa *email*-i të deputetëve të posaçëm, ndaj dhe nuk i keni marrë përgjigjet. Pra, i kemi kthyer mbrapsht për të ruajtur dhe për të respektuar Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes.

Edhe këtë model të ligjit të noterisë, nëse ju e dëshironi, mund t'jua vëmë në dispozicion që nga dita e sotme nëpërmjet sekretarisë së Komisionit të Ligjeve.

Gjithashtu, ne kemi një opinion të misionit EURALIUS, i cili ka bërë komente për pjesën më të madhe të neneve që ju tashmë i keni në projektligjin e shpërndarë, por njëkohësisht edhe për një pjesë të mendimeve dhe të sugjerimeve të ardhura në rrugë zyrtare. Ne si komision, por edhe unë në cilësinë e relatores kam printuar procesverbalet e seancave dëgjimore të zhvilluara me grupin e ekspertëve të nivelit, njëkohësisht kam marrë edhe procesverbalin e mbledhjes së datës 19 janar të vitit 2017, ku janë, për fatin tonë dhe tuajin të mirë, të gjitha diskutimet e kolegëve që kanë sjellë mendime me shkrim. Për aq sa ka qenë e mundur, kam bërë krahasimin se çfarë kanë thënë në janar të vitit 2017 dhe çfarë pretendimesh ngrenë sot. Për transparencë do të thosha se në këtë draft janë marrë në konsideratë 97% e të gjitha rekomandimeve dhe sugjerimeve të asaj tryeze. Kjo është arsyeja pse projektligji i depozituar dhe projektligji që ne sollëm për konsultim final, në kuadër të rregullave të transparencës në Kuvend që, kur një projektligj ndryshon gjatë diskutimit dhe konsultimit, ne duhet ta çojmë edhe një herë për komente, dhe tregon se ne kemi marrë në konsideratë çfarë është thënë në atë kohë nga ministri Manjani, nga të gjithë përfaqësuesit e dhomave të noterisë dhe noterët e veçantë. Edhe ky procesverbal është publikuar në faqen e Kuvendit për ata që kanë nevojë të shikojnë se çfarë kanë thënë. Me vjen keq të them se një pjesë i kanë kundërshtuar sot me mendimet që kanë shprehur. Edhe këtë mund t'jua vëmë në dispozicion.

Ky ligj do të marrë bekimin e *DG JUST*. Pra, nuk kalon pa thënë BE-ja po. Ne kemi qenë shumë të kujdesshëm që në çdo nen të marrim në konsideratë orientimet e Bashkimit European.

Është ligj në kuadër të *screening*. Ne jemi në kapitujt 23 dhe 24. Në progresraportin e BE-së ligji i noterisë dhe strategjia e edukimit ligjor janë të përmendura në mënyrë taksative. Askush nga ne, me të gjitha dëshirat që mund të kenë individë të veçantë noterë, nuk mund të dalë jashtë standardeve të këtij kodi të deontologjisë dhe direktivave të tjera.

E fundit fare, më lejoni të falënderoj Dhomën Kombëtare të Noterëve gjermanë dhe të gjithë ekspertët gjermanë që kanë qenë të pranishëm në punën përgatitore të këtij projektligji. Kanë punuar intensivisht me ekspertët dhe me mua, kanë marrë në konsideratë të gjitha përkthimet e komenteve dhe sugjerimeve tuaja të bëra më parë, qoftë me shkrim, qoftë ato që

janë bërë në mbledhjen e janarit të vitit 2017 dhe kanë punuar nen për nen. Ata nuk e kishin të mundur të vinin sot, por kanë ardhur disa herë në Shqipëri gjatë kohës së draftimit dhe reflektimit të mendimeve e të sugjerimeve të shprehura nga ju, kështu që, ne emrin tuaj, dua t'i falënderoj shumë për të gjitha komentet, sugjerimet, por edhe për punën konkrete për draftimin e neneve të veçanta.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Pa humbur kohë, fillojmë me diskutimet.

Kush e do fjalën, të ndezë mikrofonin dhe të prezantohet.

**Artan Treska** – Quhem Artan Treska, kryetar i Dhomës së Noterëve të Tiranës.

Së pari, dua të sqaroj një detaj. Takimi që ne kemi bërë në vitin 2017 dhe projektligji që na është paraqitur në atë kohë me projektligjin aktual ndryshojnë rrënjësisht. Të gjitha diskutimet kanë qenë për atë projektligj dhe për të gjithë problematikën e tij. Faktikisht për projektligjin që na është vënë para sot ne jemi njoftuar vetëm në datën 6. Para kësaj date ne nuk kemi pasur absolutisht asnjë njoftim. Me përkushtim maksimal kemi arritur të mbledhim mendimin e të gjithë noterëve të Dhomës së Tiranës, e cila është Dhoma e madhe që ka Shqipëria dhe përbën gjysmën e noterëve të Shqipërisë.

Të nderuar deputetë, pas studimit të projektligjit për noterinë nga anëtarët e Dhomës së Noterëve të Tiranës, e cila ka si anëtarë gjysmën e gjithë numrit të përgjithshëm të noterëve të Republikës së Shqipërisë, kanë nxjerrë si konkluzion përfundimtar se ky projektligj nuk përmbush asnjë nga kriteret, pritshmëritë, rregullimin, problematikën dhe përmirësimin e veprimtarisë noteriale në Shqipëri.

Të nderuar deputetë, kërkohet nga ju që projektligjin ta shikoni dhe ta vlerësoni me përgjegjësinë dhe vëmendjen e duhur, sepse në formën që na është paraqitur absolutisht nuk do ta rregullojë, por do ta shkatërrojë veprimtarinë noteriale. E them këtë, sepse keni rastin e artë që sistemin noterial ta drejtoni drejt shtetit të së drejtës dhe të mos lejoni të përfundojë në greminën ku politika e ka çuar sistemin e drejtësisë në këtë vend dhe sot përballemi me situatën që nuk funksionin as Gjykata Kushtetuese, as Gjykata e Lartë dhe ku gjyqtarët e prokurorët janë rreshtuar dhe presin radhën, sepse ka mbërritur dita e gjykimit.

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, si organ ekzekutiv i cili licencon dhe kontrollon direkt veprimtarinë noteriale, dua t'ju kërkoj të vlerësoni me shumë vëmendje dhe kujdes të gjitha konkluzionet, vërejtjet, mendimet dhe sugjerimet e dhëna nga noterët që unë përfaqësoj, me qëllim që nesër...

**Ulsi Manja** – Zoti Treska, ju lutem, për projektligjin! Mbledhjen këtu e drejtoj unë. Më duket se zonja Hysi dhe unë u fokusua drejt idesë që dua të shkojmë në BE, jo në...



**Artan Treska** – Zoti Manja...

**Ulsi Manja** – Të lutem! Mos bëni konsiderata të përgjithshme. Sot jemi në një tryezë të diskutimit teknik. A ka mundësi të më thoni se ku kërkoni të ndërhyhet në projektligjin që ke marrë në datën 6, me kapituj, me nene dhe me propozime konkrete? Ju lutem, për konsiderata të përgjithshme politike apo qëndrime të tilla, sovrani ka ngarkuar tjetërkënd. Çfarë ke në raport me projektligjin, thuaje, pra që ke një, dy, tre, katër apo pesë. Ky është fokusi i debatit.

**Artan Treska** – Zoti Manja, fjala ime ishte koncepti i përgjithshëm që ne kemi për projektligjin. Konkretisht, ne kemi një material tepër voluminoz, të cilin do t’jua paraqesim bashkë me kolegët e mi, duke filluar me shkeljet kushtetuese, me divergjencën që ka ky ligj me shumë ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë, me mënyrën si e keni draftuar dhe keni arritur deri këtu, me mënyrën si ndërthuren kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë me Dhomën Kombëtare të Noterisë, me barrën financiare që do të paguajmë ne si noterë dhe që ka për të na thyer në mes. Megjithatë, meqenëse ju nuk dëshironi ta vazhdoj fjalën time, atëherë po filloj së pari me shkeljet kushtetuese që ne kemi hasur dhe janë në materialin e përgatitur nga të gjithë noterët e Dhomës së Noterëve të Tiranës dhe i keni të gjitha të identifikuar dhe në fund do t’jua lëmë këtu.

Po ia jap fjalën koleges sime, sepse ajo është përgatitur për këtë pjesë.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, prezantohuni dhe fokusohuni tërësisht te projektligji dhe me nene konkrete, nëse është e mundur.

**Gelanda Shkurtaç** – Përsëritje të gjithëve! Ju falënderoj, zoti Manja! Është hera e parë që ju shikoj *live*, se ju kam parë gjithmonë nëpërmjet televizorit. Është kënaqësi të flasim dhe të përballemi. Gjërat që ngritët dhe elementet për të cilat folët janë absolutisht shumë të vërteta.

Ju kërkoi ndjesë, italianët kanë një shprehje: rrobat e pistë lahen në shtëpi, pra e kuptuat shumë mirë që kemi divergjenca. Kjo gjë është e qartë dhe është e shëmtuar që vijmë këtu me divergjenca dhe keni absolutisht të drejtë që s’mund të jeni jo vetëm ju si person, por Kuvendi i Shqipërisë, i cili duhet të merret me përçarjen brenda noterisë. Është absolutisht e drejtë kjo gjë. Duhet ta merrni të mirëqenë këtë fakt. Nuk kemi nevojë të betohemi, por po ju flas me gjuhë penale, me barrën e provës po ju them se 64 nga mbi 470 noterë nuk përbëjnë një element për të thënë se noteria ka qenë e informuar. Kemi qenë totalisht të painformuar. Me fjalë, e dinim shumë mirë që ishte një ligj, por asnjëherë nuk e kemi ditur. Në këtë pikë, kemi të drejtë ta lexojmë këtë projektligj dhe ta shqyrtojmë nen për nen dhe të marrin pjesë

noterët nga Tropoja deri në Sarandë për arsye se është një ligj, i cili, po kaloi, nuk mund të zhbëhet.

Papërputhshmëritë janë nga pikëpamja e transparencës së ligjshmërisë së procesit të hartimit të projektligjit. Nuk po jua lexoj se do të lodheni.

**Ulsi Manja** – Pak më ngadalë se po përkthejmë për shëfën e misionit EURALIUS dhe fokusohuni të ligji.

**Gelanda Shkurtaj** – Patjetër.

Defekte të tjera janë nga pikëpamja e risive dhe impaktit të grupet e interesit.

Për procesin e hartimit, për procesin e mospërputhshmërisë me Kushtetuan e Republikës së Shqipërisë, disa shkelje flagrante.

Një element tjetër...

*(Reagime pa mikrofon)*

Ka shumë, zotëri.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Fino!

E ka kërkuar fjalën zonja Hysi për procedurë.

**Vasilika Hysi** – Ju lutem, unë jam këtu për të mbajtur shënime dhe mbledhja po regjistrohet. Unë i kam dëgjuar këto diskutime dhe kam marrë mbi 100 e ca mendime. Ju nuk e dini, por secili nga ju ka shkruar në mënyrë individuale. Pra, gati 280 veta janë konsultuar për këtë projektligj.

*(Reagim pa mikrofon)*

Ju lutem, nëse Dhoma e Tiranës nuk ju ka mbledhur dhe nuk ju ka dhënë udhëzime, është problemi juaj i brendshëm dhe nuk dua të hyj.

**Gelanda Shkurtaj** – Nuk është e vërtetë. Dhoma e Tiranës na mblodhi ditën kur...

**Vasilika Hysi** – Jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë dhe e kam fjalën për procedurë. Rregullorja e Kuvendit thotë se fjala për procedurë ka përparësi mbi të gjithë, edhe mbi kolegët. Në cilësinë e relatores, dua nën për nën të më thoni se ky nën bie ndesh me Kushtetutën. Brenda ditës së sotme ose deri nesër do t'ju sjell riformulimin. Pra, të thoni se ky nën bie ndesh me Kodin Civil. Edhe unë kam shumë nën me të cilat jam kundër, por janë propozime të kolegëve tuaj, zonjë. Me 40% të propozimeve jam unë kundër, se bien ndesh me Kodin Civil, me Kodin e Deontologjisë, me etikën etj. Pra, për 40% jam unë kundër.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, fokusohuni te nënet konkrete!

**Sonila Bejtja** – Ju përsëndes! Quhem Sonila Bejtja, anëtare e Dhomës së Noterisë së Tiranës.

Unë kam nxjerrë shkeljet që ka ky projektligj me Kushtetutën, meqenëse duhet të jemi konkretë.

Në nenin 8, pika 2, të këtij projektligji përcaktohet se kandidat për noterë nuk mund të jetë bashkëshorti, ose i afërm i shkallës së parë i noterit pranë të cilit punon.

Gjithashtu, në nenin 15, pika 4, të këtij projektligji është përcaktuar se zëvendësnoteri nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërm i shkallës së parë i noterit pranë të cilit emërohet.

Këto dy dispozita bien në kundërshtim me parime, liritë dhe të drejtat e njohura në Kushtetutë. Neni 18 i Kushtetutës përcakton se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindja politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përgjigje e arsyeshme dhe objektive.

Në nenin 49 të Kushtetutës përcaktohet se secili ka të drejtë t'i fitojë mjetet e tij të jetesës me punë të ligjshme, të cilën e ka zgjedhur ose që e ka pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. Rrjedhimisht, neni 8, pika 2, dhe neni 15, pika 4, të këtij projektligji i kundërvihen haptazi dispozitës së Kushtetutës që sapo citova. Përrjashtimi i trashëgimtarëve të radhës së parë, siç janë fëmijët dhe bashkëshortët e noterit ose zëvendësnoterit nga e drejta për të ushtruar profesionin e noterit ose zëvendësnoterit është një diskriminim që u bëhet këtyre trashëgimtarëve për shkak të gjinisë dhe përkatësisë prindërore.

Nuk e dimë nëse ekziston ndonjë arsye e përligjur dhe objektive që është bërë një propozim për një diskriminim të tillë. Lidhja e gjinisë dhe e asaj prindërore nuk mund të jetë arsye e përligjur dhe objektive për të bërë një diskriminim të tillë. Unë jam shkolluar në Itali. E kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në Milano. Kam pasur rastin të punoj edhe në zyrë noteriale dhe di të them se një nga kriteret e cilësimit të noterit është trashëgimia ndër fëmijë që krijohet e detyruar nga raporti i konfidencialitetit me klientelën, që është pika bazë dhe deontologjia bazë e noterit në vendet e BE-së.

Nga ana tjetër, ushtrimi i detyrës së noterit ose zëvendësnoterit nga bashkëshortët ose fëmijët e tyre është në dobi të vetë veprimtarisë noteriale në kuptim të kësaj vazhdueshmërie, të ruajtjes dhe të mirëmbajtjes së arkivit, të sekretit dhe të konfidencialitetit për aktet noteriale të hartuara në zyrën e noterit.

Ligji aktual njeh të drejtën e trashëgimtarëve të noterit të kenë përparësi, nuk po them trashëgimi, në raport me personat e tjerë që konkurrojnë, pavarësisht faktit se të gjithë i nënshtrohen një konkursi dhe një provimi.

Përrjashtimi i bashkëshortit ose i fëmijëve të noterit nga konkurrimi për noter dhe për zëvendësnoter cenon të drejtën e zgjedhjes së lirë të profesionit nga individi. Të gjitha këto janë të përcaktuara në nenin 49 të Kushtetutës. Në sugjerim që të hiqen këto dispozita nga përmbajtja e projektligjit.

Neni 8, pika 7, i projektligjit. Është parashikuar punësimi i kandidatëve për noterë pranë një zyre noteriale. Në këtë dispozitë përcaktohet detyrimi i noterit që të paguajë kandidatin me jo më pak se 125% e pagës minimale mujore në shkallë vendi. Gjithashtu, noterit detyrohet të paguajë taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kandidatin sipas ligjeve përkatëse dhe Kodit të Punës.

Këto detyrime, sipas mendimit tonë, nuk janë në pajtim me veprimtarinë e noterit, pasi kjo veprimtari është private. Pra, ne ushtrojmë një funksion publik, por organizohemi në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare. Ne jemi person fizik dhe ushtrojmë një sipërmarrje të lirë private që sanksionohet edhe në Kushtetutë. Duke qenë e tillë, marrëdhënia kontraktuale i nënshtrohet lirisë së përzgjedhjes së personave që ne punësojmë dhe u nënshtrohemi të gjitha detyrimeve që janë të përcaktuara edhe në Kodin e Punës dhe në ligjin për tatim-taksat në Republikën e Shqipërisë.

Detyrimi që na imponohet neve për të paguar për kualifikimin e një kandidati bie ndesh me parimet dhe me mënyrat e kualifikimit gjatë dhe në veprimtarinë private. Pra, nuk besoj se ka aktivitet privat, ku një sipërmarrës kualifikon dikë dhe e paguan për kualifikimin e tij. Të gjithë e dimë që ushtrohen praktika të lira pranë zyrave ligjore, ku vendosin palët se si i përcaktojnë marrëdhëniet e tyre të shpërblimit, pra marrëdhëniet dypalëshe. Në radhë të parë, noterit nuk mund të detyrohet të pranojë për kualifikim një kandidat. Unë nuk kam mundësi ta pranoj, se nuk e kam atë volum punë që të marr një kandidat dhe të paguaj për kualifikimin e tij. Jo të gjithë noterët kanë punë. Është tërësisht në diskrecion të noterit, për shkak të karakterit privat të veprimtarisë së tij, të marrë ose të pranojë një person ose kandidat për t'u kualifikuar pranë tij. Kjo është njësoj sikur t'i kërkosh, apo më keq të detyrosh një individ të regjistruar si tregtar, person fizik, të marrë një kandidat për kualifikim në fushën e biznesit që ai ushtron.

Kandidati që kualifikohet gjatë periudhës së pranimit të noterit mendojmë se duhet t'i përballojë vetë shpenzimet e tij. Noteri kurrsesi nuk mund të ngarkohet me detyrime të tilla financiare, që vijnë haptazi në kundërshtim me aktivitetin privat të noterit, gjë që bie në kundërshtim me ligjin për shoqëritë tregtare, me Kushtetutën, sipërmarrjen e lirë dhe iniciativën e lirë. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë ndërhyrje në aktivitetin privat pa shkak të përlegjuri apo ndonjë interes të rëndësishëm publik justifikues.

Në nenin 10, pika 1, të projektligjit përmendet shprehja “Banor/rezident”. Kjo shprehje ne mendojmë se është e gabuar, pasi banorë/rezident mund të jetë edhe një i huaj. Nga ana tjetër, shtetasit shqiptarë mund të jenë banorë, por mund të mos jenë rezidentë për një periudhë kohe të shkurtër ose gjatë. Kjo shprehje do të krijonte një konfuzion për përcaktimin e numrit të banorëve për efekt të përlllogaritjes së numrit të noterëve. Pra, ligji përcakton që duhet të jetë një noter për kaç banorë/rezidentë. Për mendimin tim, shprehja “Banor/rezident” është pak evazive.

Një moment tjetër që nuk gjen mbështetje kushtetuese është edhe e drejta që i njihet ministrit të Drejtësisë sipas nenit 10, pika 6, të këtij projektligji, të urdhërojë një noter të një rrethi të caktuar gjyqësor të shkojë e të kryejë deri në 4 ditë shërbim në muaj detyrën e noterit në një bashki të një rrethi gjyqësor tjetër, ku nuk ka zyrë noteriale. Kjo e drejtë që i jepet ministrit të Drejtësisë ne mendojmë se është gabuar dhe jokushtetuese, pasi bie ndesh me lirinë e veprimtarisë private, ndërsa nga ana tjetër e drejta e ministrit përbën një detyrim për noterin. Pra, ne kemi konstatuar që në këtë ligj ne vërtet tentojmë të rregullojmë veprimtarinë noteriale në impakt të qytetarit, por këtu shikohen vetëm detyra dhe obligime të noterit, ndërsa të drejtat nuk i kemi parë deri sot te ky projektligj.

Gjithsesi, e thënë më hapur, kjo punë e detyruar që i ngarkohet noterit bie drejtpërdrejt ndesh me nenin 4 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe me nenin 26 të Kushtetutës.

Në nenin 25 të projektligjit është përcaktuar detyrimi i noterëve të paguajnë shpenzimet e inspektimit për çdo inspektim periodik që kryhet ndaj tyre sipas këtij projektligji. Këtu dua të ndalem pak, sepse është për të mirën e të gjithë noterëve. Ne detyrohemi për çdo inspektim periodik të paguajmë inspektorët, që do të thotë se është njësoj sikur për çdo inspektim që bëjnë organet e administratës tatimore të paguajë klienti, që do të thotë të paguajmë ne. Ne jemi tatimpagues dhe arsyeja pse ne nuk i paguajmë inspektorët e tatimeve është pikërisht sepse ne paguajmë taksa. Fakti që ne duhet të paguajmë inspektorët, që na vijnë për kontroll periodik, na mbingarkon me dyfishim tatimi. Ky është një lloj tatimi në xhepat tanë dhe do të shkojë në shërbim të klientit, sepse ne këta lekë do t’i grumbullojmë dhe në fund të ditës do t’ia marrim personit më të diskriminuar, që është qytetari. Inspektorët janë staf publik dhe paguhen nga buxheti i shtetit, nuk kanë pse të paguajnë, sepse edhe inspektorët që bëjnë kontrolle periodike paguhen nga buxheti.

Një moment tjetër racional lidhet me nenin 27, germa “d”, sipas së cilës një noter mund të pezullohet deri në 10 vjet. Për mendimin tim, më mirë t’i hiqet licenca sesa të pezullohet.

Neni 64 i këtij projektligji, për mendimin tim, është parashikim shumë i rëndë, sepse përcakton administrimin, deri diku, me dhunë të zyrës së një noteri nga një zëvendësnoter apo noter tjetër gjatë kohës së pezullimit. Ne flasim për shërbim noterial, ku çdo noter deponon firmën pranë të gjitha organeve shtetërore, pranë njësive diplomatike dhe pranë Ministrisë së Jashtme, por, në qoftë se mua për inate personale dhe subjektive të dikujt më vjen një kontroll dhe më pezullohet zyra, ku më futet një zëvendësnoter, i cili në emër dhe për llogari time harton akte noteriale, firmos në emrin tim dhe nesër mund të dalin me probleme, kujt i ngelet kjo përgjegjësi? Ai përdor vulën time, që është personale, për të cilën unë kam paguar dhe përgjigjem përpara shtetit, më merr klientelën, më përhap një informacion që është superkonfidencial, për të cilin unë nuk e di se çfarë pasojash mund të ketë administrimi i detyruar i një zyre.

Gjithashtu, te ky nen flitet se të ardhurat gjatë këtij momenti, që mblihen nga zyra e noterit të larguar, ku është futur me dhunë një zëvendësnoter, këto të ardhura ndahen: një përqindje dhomës së noterëve, një përqindje zëvendësnoterit dhe çfarë mund të dalë nga fitimi i shkon noterit të pezulluar. Unë mendoj se është shumë abuzive dhe lë vend edhe për evazion fiskal.

Një moment tjetër i gabuar dhe i pabazuar është përcaktimi i mënyrës sesi do të ndahen fitimet.

Neni 66, pika 2, parashikon se noterit këshillohet palët për të gjitha çështjet ligjore, që lidhen me administrimin preventiv të drejtësisë, por pa u kufizuar në hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve të të gjitha llojeve dhe të asistojë në procedimin e transaksioneve, si dhe të përfaqësojë palët përpara gjykatave dhe autoriteteve kompetente, me përjashtim të rasteve kur kjo e drejtë kufizohet nga ligjet e tjera. Kjo dispozitë e vesh noterin me detyra, të cilat nuk kanë lidhje dhe dalin jashtë detyrës së noterit, madje këto detyra të noterit krijojnë konflikt ndërmjet detyrës së noterit që ka lëshuar akte të caktuara noteriale për dy ose më shumë palë dhe përfaqësimin të tyre në gjykatë. Palët mund të jenë në gjyq për një akt noterial të lidhur ndërmjet tyre para noterit dhe noterit në asnjë mënyrë nuk mund të këshillojë se përfaqëson vetëm një palë kundër tjetrës, sepse të dyja kanë qenë të pranishme gjatë kryerjes së akteve noteriale dhe supozohet që noterit të jetë asnjë dhe është neutral. Kjo është njësoj sikur të ngarkosh një avokat me detyra noteriale dhe për të njëjtin veprim juridik avokati të përfaqësojë një palë kundër tjetrës. Unë mendoj se këto konflikte interesi duhet të shmangen, me qëllim që të realizohet siguria juridike e palëve dhe siguria e aktit noterial në vetvete. Pra, përfaqësimi në gjykatë duhet përcaktuar, sepse noterit mund të jetë avokat, dhe nëse është avokat, duhet t'i

nënshtrohet Dhomës së Avokatisë dhe duhet të paguaj kuotizacione. Domethënë, është shumë e ndërlikuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jam pak detajiste, ju lutem mos e humbisni durimin!

**Ulsi Manja** –Diskutimi është në rrjedhën që ne duam, por ka dy gjëra: diskutimet janë të regjistruara dhe që të gjitha do t’i lësh me shkrim, por gjithsesi për ato që do të ndash me kolegët mund të vazhdosh.

**Sonila Bejtja** – Kalojmë te neni 69, pikat 2, 3, 4 dhe 5, ku parashikojnë sigurimin kolektiv të noterëve nga Dhoma Kombëtare e Noterisë me vendim të shumicës së Asamblesë së Përgjithshme. Pra, edhe kjo lë vend për evazion, sepse unë mund ta zgjedh vetë kompaninë e sigurimit.

Neni 72, pika 2, është shumë interesante për t’u parë. Unë dua që ta konsultojmë edhe me përfaqësuesit e EURALIS-it. Kjo pikë përcakton vlerën e transaksioneve financiare me para në dorë, kesh, për shuma më të mëdha se 10,000 lekë të rinj. Një përcaktim i tillë bie në kundërshtim me ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimit të dalë në zbatim të tij, të cilët përcaktojnë si vlerë për transaksione financiare me para në dorë 150000 lekë të rinj.

Neni 81, pika 2, përcakton se paga e zëvendësnoterit nuk mund të jetë më e ulët se 150% e pagës minimale mujore në shkallë vendi, sipas legjislacionit në fuqi. Pa u zgjatur, dua të them se kjo pikë bie në kundërshtim me lirinë kontraktore në marrëdhëniet e punës. E thashë edhe më parë, atje ku unë përcaktoja kandidatin për noter isha e detyruar t’i vija një rrogë, që është 125, dhe 150 është në kundërshtim me lirinë e veprimtarisë sime ekonomike.

Neni 91, pika 5, i projektligjit përcakton se mandati i kryetarit dhe zëvendëskryetari i Dhomës Kombëtare të Noterisë për 4 vjet kanë të drejtën të rizgjidhen për një mandat tjetër. Për të evituar çdo dyshim dhe keqinterpretim, ne sugjerojmë që të saktësohet se kryetari dhe zëvendëskryetari mund të zgjidhen vetëm për dy mandate. Kjo të jetë taksative dhe të mos lerë shteg për keqinterpretim dhe abuzim në të ardhmen.

Neni 104 i këtij projektligji e ndalon noterin të kryejë aktin noterial kur vetë ose bashkëshorti është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë. Këtu nuk është përcaktuar se çfarë kuptohet me shkallë të katërt apo krushqi në shkallë të dytë. Kjo është bërë sipas radhëve të trashëgimisë bazuar në Kod Civil apo ka ndonjë kuptim tjetër?

Neni 127 pika 2, mendojmë se duhet të eliminohet, pasi ky është rregulluar në Kodin Civil. Pra nuk kemi pse bëjmë një mbivendosje, duke qenë se e ka rregulluar ky Kod.

Gjithashtu, unë jashtë këtij relacioni dua të diskutoj faktin se në një nga nenet e projektligjit përcaktohet që noteri që mungon më shumë se 7 ditë për arsye të përligjura, duhet të kërkojë me shkrim miratimin e Dhomës Kombëtare. Ne jemi aktivitete privat dhe unë marr përsipër risqet dhe fitimet e këtij aktiviteti dhe, nëse unë cilësohem si punonjëse e administratës shtetërore, kam përshtypjen se ne duhet të rregullohemi me një ligj komplet tjetër. Unë jam profesion i lirë dhe nuk mund të pres nga Dhoma Kombëtare të më japë leje për t'u larguar nga zyra. Pse e them këtë?! Sepse numri i noterëve është i mbingarkuar dhe shërbimi ndaj klientit nuk mungon. Ne na kanë zili edhe farmacitë, në çdo cep ka noterë dhe, nëse shërbimin nuk e gjen tek unë, do ta marrë tek tjetri, por mua më pezullohet licenca për 10 vjet nëse nuk marr leje.

**Ulsi Manja-** Këtu ke të drejtë, sepse, edhe nëse i ke letrat në dorë dhe s'të pëlqen noteri, ikën e shkon te tjetri.

**Sonila Bejtja** – Është e drejta e gjithsecilit të zgjedhë noterin.

Këto ishin shkeljet kushtetuese, që unë mendoj se janë për t'u parë.

**Ulsi Manja** –Shumë faleminderit, zonja Bejtja!

Relatorja ka një pyetje për përfaqësuesen e Dhomë së Tiranës.

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit për prezantimin konstruktiv dhe konkret!

Kam një pyetje lidhur me nenet 8 dhe 15, paragrafi 4, lidhur me bashkëshortët. Ju thatë se kjo cenon nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 49, por a cenon propozimi juaj parimin e barazisë para ligjit dhe të meritokracisë kur ju u shprehët që në konkurrin fëmijët dhe bashkëshortët duhet të kenë përparësi? Ndërkohë, është edhe parimi tjetër, jemi të barabartë para ligjit, është meritokracia, testimi dhe gjithçka tjetër. A mund të ma shtjelloni pak se çfarë kuptoni me “Përparësi”?

**Ulsi Manja-** Pyetja është shumë e qartë dhe zonja Hysi thotë se kemi përplasje parimesh kushtetuese. Çfarë kuptoni me “Përparësi”?

**Sonila Bejtja** – Unë nuk mendoj se ka një lloj klientelizmi në marrjen e licencës së noterisë. Me sa di unë, deri sot, përveç parashikimit që është hequr nga ligji aktual i trashëgimisë së profesionit të noterit, noteri, fëmija i të cilit futet në provim, jep dorëheqjen dhe del nga sistemi i noterëve. Pra, bëhet fjalë për një zëvendësim me përparësi bonusi, gjë që nuk do të thotë se ky fëmijë nëse nuk është i përgatitur do ta fitojë detyrimisht. Ne kemi rastet e kolegëve tanë, të cilët kanë futur fëmijët në provim dhe fëmija nuk e ka marrë provimin. Pra, nuk besoj se diskriminohen të tjerët. Nga radhët e noterëve janë shumë pak ata që kanë bërë fëmijët noterë, por kjo garanton cilësinë e shërbimit, sepse, në qoftë se fëmija rri në zyrën time, njohurinë që do të marrë nga unë do të jenë shumë më të mira sesa njohuritë që do të marrë



nga një kolege imja, e cila nuk është e interesuar ta shkollojë, ndërsa unë jam e interesuar t'i jap të gjithë arkivin, databasën dhe njohuritë e mia. Pra, kjo nuk përbën faktor që fëmija im të përjashtohet nga aktiviteti i noterisë ose qëndrimi në zyrën time.

**Ulsi Manja** –Zoti Braho, fjala për ju!

**Spartak Braho** – Kur është vendosur në dispozitë ky përcaktim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në vitin 2005.

**Spartak Braho** – Pse është antikushtetuese, kur ky përcaktim i është referuar kësaj Kushtetute që kemi sot?

**Sonila Bejtja** – Është antikushtetuese që unë nuk mund ta mbaj fëmijën tim si zëvendësnoter ose kandidat për noter dhe përjashtimi i kësaj të drejte bie ndesh me Kushtetutën, pastaj, nëse fëmija im do të jetë i paaftë, do ta përcaktojë komisioni.

**Ulsi Manja**- Kolegët e mi deputetë janë për të bërë pyetje dhe për të marrë përgjigje, sepse qëndrimin tonë ne kemi ku e manifestojmë në ditët në vazhdim. Do të kemi debate, diskutime dhe në fund do të kemi një vendimmarrje. Kështu që sot kemi durimin që t'ju dëgjojmë të gjithëve me radhë. Kush e do fjalën? Ju lutem, prezantohuni!

**Elona Saliaj** – Përshëndetje, jam Elona Saliaj, anëtare e Këshillit të Dhomës së Noterisë në Tiranë, e zgjedhur nga kolegët.

Po e nis diskutimin nga fundi i diskutimit, nga pjesa e trashëgimisë. Pashë dhe lexova nga kolegët e mi dhe më erdhi shumë keq për mënyrën sesi e transmetonin këtë nen të gjithë noterët, duke e quajtur shkelje të së drejtës së trashëgimisë. Më mirë se kushdo jurist tjetër dhe profesionist, këtë e dinë noterët, kur fitohet trashëgimia dhe si fitohet, ajo fitohet me ndërrimin e jetës së trashëgimtarit, por nuk trashëgohen të dhënat që lidhen personalisht me personin dhe ushtrimin e funksionit të tij, siç është edhe ai i noterit.

Koncepti i përdorur nga noterët për heqjen e dispozitës për trashëgiminë thuhet se është historikisht. Në fakt, është vendosur në vitin 2014 dhe si dispozitë përjashtuese. Nëse shikoni nenin 3/a të ligjit aktual, e keni me *footnote*, po e citoj: “Në përjashtim të kushteve dhe procedurave normale, ministri i Drejtësisë mund t'i ofrojë kandidatit për noter licencën e bashkëshortit ose të prindit të larguar për shkak të ndërrimit të jetës; për shkak të mbushjes së moshës ose për shkak të largimit nga detyra”. Ky është përjashtim nga rregulli dhe përjashtimin nga rregulli ne jemi mësuar ta bëjmë rregull të përgjithshëm. Kjo ka ndodhur vitet e fundit, ku të gjithë fëmijët e noterëve kanë zëvendësuar në masë prindërit e tyre noterë.

Natyrisht, nuk jam kundër vendosjes së kësaj dispozite dhe mendimit që dhanë kolegët, sepse, ashtu sikurse edhe ata, në këto tryeza i kemi kundërshtuar edhe ne. Madje kam

pasur një diskutim me profesoreshë Hysin, e cila, me të drejtë, pyeti: “Pse duhet ta cenojmë parimin e meritokracisë për të tjerët, që nuk i kanë prindërit noterë?” Personalisht jam notere dhe nuk i kam prindërit as noterë, as juristë dhe me këtë dispozitë do të duhej të prisja radhën, sikurse edhe e kam pritur, për vite të tëra, për të ardhur në Tiranë, për shkak se më zihej vendi nga fëmijët e noterëve, sa herë që këta të fundit largoheshin nga detyra.

Në lidhje me pjesën e procedurës, përderisa jam anëtare e Këshillit të Dhomës së Noterisë Tiranë, dua t’ju theksoj, edhe pse ju nuk duhet të kishit interes dhe nuk duhet t’i dini problemet që ne kemi përbrenda, që Dhoma e Noterisë Tiranë përbëhet nga nëntë anëtarë, ku një prej të cilëve jam edhe unë; kryetari i Dhomës së Noterisë Tiranë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jemi organ kolegjal dhe kryetari i Dhomës së Noterisë Tiranë është një *primus inter pares* (është një i parë ndërmjet të barabartëve) dhe ka vetëm një votë në këshill, por për të gjithë këtë iniciativë private që ka ndërmarrë nuk e ka pyetur dhe nuk e ka mbledhur këshillin për t’i marrë mendimet, por ka shpërndarë, në mënyrë alarmante, të gjitha *email*-et kundrejt kolegëve, madje ka tejkaluar kompetencat e tij, duke i shpërndarë edhe jashtë territorit të Tiranës.

Megjithatë, këto janë çështje të brendshme tonat.

*(Debat në sallë)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, se kjo nuk është shtëpia ku mund të bëni debat!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, ju lutem!

Zonja Saliaj, mbaruat?

**Elona Saliaj** – Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem shumë, çfarë të keni njëri me tjetrin, diskutojeni në shtëpinë tuaj, ndërkohë këtu jeni në shtëpinë tonë dhe në shtëpinë tonë-rregullat i përcaktojmë ne!

A mblidheni ju, a derdheni ju, kjo është puna juaj, por se si mblidheni dhe derdheni ju, edhe këtë e dimë përsëri ne! Dakord? Pra, këtu jemi thjesht për diskutimin teknik të projektligjit.

Unë e pëlqej shumë këtë natyrë diskutimi: foli zonja Bejtja, foli kolegia, foli kolegia tjetër... Tani, kush e do fjalën për t’u marrë me projektligjin?

**Mimoza Sadushi** – A mund të flas unë?

**Ulsi Manja** – Po, zonja Sadushi, në fakt do të duhet t’jua kishim dhënë fjalën që në fillim, pasi jeni kryetarja e Dhomës së Noterisë...

**Mimoza Sadushi** – Nuk ka problem, se të gjithë njësoj jemi.

**Ulsi Manja** – ...dhe, në mos gaboj, jeni zgjedhur me votën e tyre. Kështu që, fjalën mund ta merrni.

Fjala është për ju.

**Mimoza Sadushi** – I nderuar zoti Manja,

E nderuara zonja Hysi,

E nderuara zonja Bernhard,

Të nderuar kolegë,

Fillimisht dëshiroj t'ju falënderoj për angazhimin tuaj maksimal në lidhje me ndryshimet në ligjin "Për noterinë"!

Kuptohet që synimi i gjithë kësaj nisme ka qenë që të përmirësohej veprimtaria noteriale dhe të përafrohej me standardet europiane.

Siç jeni në dijeni, diskutimi për projektligjin ka filluar që në vitin 2015, kur kemi filluar punën që atëherë me zotin Regner, me të cilin kemi pasur mjaft diskutime, mjaft debate konstruktive dhe në fund përgatitëm projektligjin e parë me disa ndryshime. Ky projektligj, së bashku me relacionin, i është dërguar zotit Xhafaj, që në atë kohë ka qenë kryetar i këtij komisioni, dhe zonjës Shtylla.

Në këtë relacion janë përmendur të gjitha pikat me ndryshimet që i janë bërë ligjit si në vendosjen e kriterëve të reja për marrjen e licencës së noterit, ashtu edhe për propozimet e Dhomës Kombëtare në lidhje me disiplinën apo edhe për ndryshimet që preknin pjesën organizative të dhomës, ndryshime të cilat janë propozuar nga eksperti i EURALIUS-it. Në këtë relacion Dhoma Kombëtare e Noterisë është shprehur që gjykon se organizimi i brendshëm, ndryshe nga ai ekzistues, ashtu siç paraqitet në projektin e ekspertit të EURALIUS-it, është një ndryshim i sforcuar, i cili bie në kundërshtim edhe me traditën mbi njëzetvjeçare që ka ky institucion. Pra, ishte pikë me të cilën ne nuk kemi qenë dakord me ekspertin e EURALIUS-it, ndërkohë që kemi qenë dakord me mendimet e ekspertit të EURALIUS-it për krijimin e bordit disiplinor dhe bordit të auditit.

Risi tjetër e atij projekti ishte krijimi i Qendrës së Trajnimit të Noterëve, nëpërmjet së cilës synonim trajnimin fillestar dhe atë vazhdues për noterët.

Një tjetër mendim kundër i Dhomës ishte edhe trajnimi që parashikohej për kandidatët e rinj, që të ishte 3 vjet. U kundërshtua nga Dhoma, duke thënë se del jashtë kontekstit shqiptar, dhe kërkuam që ky trajnim të ishte një vit, meqenëse çdo kandidat do të bënte edhe dy vjet stazh pranë një noteri.

Propozimi tjetër dhe më i rëndësishëm ishte vendosja e një raporti noter – banor, që e kishim parashikuar 1 për 10,000 banorë.

I gjithë ky projektligj me ndryshimet u është shpërndarë të gjithë noterëve të Republikës së Shqipërisë, sipas *email*-eve që unë kam këtu, në datën 10 tetor. Kanë dhënë mendimet e tyre, kanë diskutuar, kemi komunikuar deri në datën 26 tetor dhe të gjitha mendimet që kanë dhënë i kanë kaluar Kuvendit të Shqipërisë.

Përsëri më 3 nëntor u kam dërguar *email*-e, ku i kam falënderuar të gjithë për mendimet dhe pas këtij komunikimi kemi organizuar takimin në Kuvend, ku ju prezantoni dhe thoni që janë dhënë mendimet.

Përsëri, duke marrë për bazë mendimet e noterëve, u bënë disa ndryshime të tjera të projektligjit dhe ky projektligj, përsëri me ndryshime, të cilin ne synonim ta miratonim përpara Kongresit të Noterisë, u është dërguar përsëri noterëve në datën 28 mars...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në nëntor përpara Kongresit. Por ky projektligj nuk u miratua përsëri.

Kaluam edhe kongresin dhe në datën 28 mars të vitit 2017 unë u kam dërguar përsëri email të gjithë noterëve me këtë përmbajtje: “Të nderuar kolegë, po ju dërgoj edhe një herë shtesat dhe ndryshimet në ligjin “Për noterinë”.”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

I kam të gjitha *email*-et këtu.

Që nga marsi i vitit 2017 deri në shtator nuk jemi angazhuar më me projektligjin “Për noterinë”. Në shtator...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Sepse u vendos që do të bëhej ligji i ri meqenëse kishte shumë ndryshime, sipas mendimeve të dhëna nga noterët.

Në shtator na paraqitet projekti i ri, përgatitur nga ekspertët e EURALIUS-it. Siç e kam marrë projektin, ia kam shpërndarë grupit të punës, i cili përbëhet nga disa noterë dhe dy pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, duke u thënë: “shikoni projektin” dhe ka vazhduar puna me grupin e punës (me përfaqësues nga EURALIUS-i, Dhoma Kombëtare dhe Ministria e Drejtësisë).

Në dy takimet e fundit që kemi pasur, përpara *email*-it të fundit të dërguar, atij të datës 5, ne kemi qenë ende të padakordësuar me disa pika kryesore të ligjit. Pra, projekti nuk ishte ende i përfunduar. Një nga pikat kryesore ishte ushtrimi i kontrollit, ku ne, si Dhoma Kombëtare, kërkuam që kontrolli të mos bëhej nga ekspertë të pavarur, por nga dy përfaqësues nga ministria (dy inspektorë të Ministrisë së Drejtësisë) dhe një përfaqësues nga Dhoma, të

cilin ta paguante Dhoma, pasi nuk ka pse noteri që kontrollohet të paguajë për grupin e kontrollit.

Pika tjetër e rëndësishme ishte se nuk kishim vendosur ende për zëvendësnoterin, meqenëse ministria kundërshtonte në lidhje me të; nuk kishim vendosur ende për bordin disiplinor, ku ne si dhomë kombëtare kërkonim që bordi disiplinor të përbëhej nga pesë anëtarë, ku dy të ishin përfaqësues nga Dhoma, dy nga ministria dhe njëri të ishte i pavarur. Ndër të tjera, si Dhomë Kombëtare, kishim kërkuar që pezullimi i aktivitetit të mos ishte dhjetë vjet, por pesë vjet, meqenëse afati dhjetëvjeçar krijonte një shkëputje totale nga veprimtaria e noterit, si dhe ishim në diskutime në lidhje me dhënien e masës disiplinore “pezullim” dhe “heqje licence” vetëm me fillimin e hetimit ndaj noterit. Pra, edhe këtë e kishim kundërshtuar, por ishim në diskutime me të gjithë.

Dua t’ju bëj me dije këtu se nga Dhoma Kombëtare është kërkuar vazhdimisht që duhet të dalim me një mendim të përbashkët. Pra, projektligji duhet të ishte i aprovuar nga të gjithë: EURALIUS-i, Dhoma Kombëtare dhe Ministria e Drejtësisë, përpara se të dilte para jush në komision, të paktën ne si dhomë kombëtare këtë kishim kërkuar. Deri këtu jemi te pjesa e shpërndarjes së projektligjit.

Tani, pas shpërndarjes së tij, i keni marrë përsëri si Kuvend mendimet, të paktën edhe ato që më janë dërguar mua jua kam kaluar përsëri, dhe mund të vazhdojmë me diskutimet e tjera.

Kjo ndërhyrje imja ishte më tepër për transparencë të procedurës që është ndjekur.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zonja Sadushi!

Në fakt, e mira kjo do të ishte që, si konsultë përfundimtare e projektligjit, të mos merreshim ne me të gjithë noterët e Republikës së Shqipërisë, pra me 470 noterë, por, në fund të fundit, organet përfaqësuese të Dhomës të vinin dhe të konsultoheshim bashkë: Ministria e Drejtësisë, Dhoma, EURALIUS-i dhe Kuvendi. Kjo është procedura normale.

Megjithatë, në funksion të transparencës, të diskutimit dhe të përmirësimit të projektligjit, nuk ka asgjë të keqe edhe përfshirja në këto diskutime e 470 noterëve që ka Shqipëria. Ajo që ne kuptuam këto ditë është se bërja e një ligji të ri për noterinë është domosdoshmëri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është e gjitha.

Pra, rihapja e këtij diskutimi ka forcuar bindjen time dhe të kolegëve të mi se absolutisht do të duhet ndërhyrje te ligji. Kaq.

Kush e do fjalën?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Keni pyetje, zoti Hyseni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjala është për ju, zoti Hyseni.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, por dëshiroj t'i ftoj ata që të jenë pak më konkretë. Për këtë arsye unë do të bëj disa pyetje, në mënyrë që ne vetë të mbajmë shënime dhe gjatë periudhës tjetër, kur nuk do të jemi me ju, ku do të kemi diskutime në komision, të bëjmë reflektime aty ku mendojmë ne se mund të ketë vend për reflektime dhe aty ku besojmë që nuk është e nevojshme të qëndrojmë në variantin e ligjit!

Së pari, ngritët pretendimin se ka praktikë në vendet e BE-së për trashëgiminë ose quasi-trashëgiminë, si një formë bonusi. Ju lutem, nëse është dikush mund të na japë një përgjigje konkrete sot, të na thotë një vend të Bashkimit Europian, që e ka një praktikë konkrete. Nëse nuk është e mundur sot, të na e nisë një ditë tjetër.

Së dyti, lexova një material, që na është paraqitur, që më duket se përputhet edhe me disa ide të miat. Për shembull, për sa u përket përplasjeve që vijnë me Kodin Civil, Kodin e Punës e të tjerë, duhet të jemi konkretë se në cilat dispozita ndodh kjo; ky është edhe synimi i konsultimeve.

Ekspertët, sado të mirë të jenë, nuk mund të jenë perfektë dhe jo gjithnjë realizojnë akte perfekte, por bëjnë konsulta dhe eliminojnë gabimet. Le t'i nxjerrim konkretisht në cilat dispozita kemi qoftë edhe përsëritje, sepse në parim unë nuk jam dakord që gjërat që janë në kodet kryesore t'i marrim dhe t'i vëmë këtu. E ka Kodi Civil, ka mbaruar; noteri i referohet Kodit Civil në 90 e kusur të punës së tij. Dakord? Pjesa tjetër është administrative; po ashtu me Kodin e Punës për ato që bien ndesh, po kështu me ligjet e tjera.

Por duhet të keni parasysh një gjë: në raste të caktuara, ky ligj mund të ketë rregullime edhe më të avancuara sesa ligjet e tjera. Për shembull, se ngritët çështjen e projektligjit “Për procedurat tatimore”, unë jam dakord që mund ta heqim fare, nuk ka pse ta referojmë si shumë, por në ndonjë rast të caktuar, sidomos për çështje që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, duhet të kemi disa rregullime ekstra. Ne nuk mund të themi se bie ndesh me ligjin “Për procedurat tatimore”, nëse vëmë një barrierë dhe një kufi tjetër. Kufiri që është aty besoj se është i ulët, por synimin e ka edhe në këtë aspekt.

Domethënë, kuptoni se edhe ju vërtet jeni profesion privat, por...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Me karakter të plotë publik, madje në këtë pikë besoj se nuk ka debate as mes jush.

Së treti, ngritët shqetësimin për çështjen e një programi të ardhshëm dixhital. Ku është konkretisht në ligj ky shqetësim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të mos u referohemi deklaratave publike.

Të mos u referohemi preferencave personale të Alketit apo të Fatmirit, apo kujt do tjetër. Nëse kemi shqetësim në ligj, t'i bëjmë barrierë, se ne pikërisht këtë duam të bëjmë: të mos lëmë hapësira që nesër, kushdoqoftë në drejtimin e organeve tuaja, të luajë me hapësirat ligjore.

Këto kisha kryesisht, zoti kryetar, por në përgjithësi, në parim, kërkoj që pjesëmarrësit të jenë pak më konkretë, jo thjesht se ne nuk kemi kohë, ne kemi kohë, sepse për këtë punë jemi votuar, që të bëjmë ligje dhe t'ju dëgjojmë juve, por le të jemi racionalë në atë që themi.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Po, zoti Martini.

**Vasil Martini** – Përshëndetje!

Unë jam Vasil Martini, anëtar i Këshillit Kombëtar të Dhomës së Noterisë. Dua të bëj disa sugjerime paraprakisht për disa ndryshime ose për ato që mendoj unë se duhen parë.

Në kuadrin e përafrimit të legjisllacionit me atë të Bashkimit European, do të thosha se ka ardhur koha sot që ne të shohim mundësinë, si kompetencë e noterit, për rastet e divorceve kur nuk kanë pasoja. Ne vërtet sot, gjatë ushtrimit të detyrës, bëjmë paraprakisht marrëveshje për zgjidhje martesore me pëlqim reciprok, por kur nuk kanë pasoja...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po jap një shembull të thjeshtë. Vetëm nga Lezha eliminohen në vit tridhjetë gjyqe. Besoj se kësaj i ka ardhur koha të rishikohet, sepse është pjesë që funksionon në të gjitha vendet e Bashkimit European.

Është një kompetencë që duhet parë, pasi ka të bëjë edhe me ndryshimin e Kodit Civil...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kodit të Familjes, por unë po e shtroj si mundësi duke qenë se jemi te ligji.

Për sa i përket nenit 69, në lidhje me zgjidhjen e kontratës kolektive, nga ana e Dhomës Kombëtare të Noterisë është propozuar ai variant, sepse krijon një mundësi.

Edhe me nenet në vazhdim, edhe me pjesën e detyrave që ka Dhoma Kombëtare në raport me noterët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...krijon një mundësi që, e para, të fillohet të paguhet siguracioni për përgjegjësinë profesionale për të gjithë noterët. Në pikëpamjen ekonomike, është e mundur të kryhet me një kontratë kolektive nga Dhoma, sepse kushton më lirë në pikëpamjen financiare dhe ke një mbulim të plotë të territorit dhe të profesionit për të gjithë noterët sipas policave, të cilat duhet të jenë individuale, të nënshkruara nga secili, por kontratën dhe mënyrën e organizimit do ta bëjë Dhoma Kombëtare, prandaj janë sugjeruar dispozitat ligjore në këtë formë. Megjithatë, ne mbetemi të hapur për çdo lloj diskutimi në këtë pikë.

Pikën 3 e nenit 72, për transaksionet do ta komentoj pak më vonë, sepse ...

**Vasilika Hysi** – Mos i përsërisni gjërat për të cilat është folur, sepse janë mbajtur shënime!

**Vasil Martini** - Te neni 72 mendoj të shtohet pika 5, në rast se noteri vdes ose ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në këtë rast, në periudhën e ndërmjetme duke qenë se transaksionet për pasuritë e paluajtshme kryhen nëpërmjet depozitimit të parave në llogarinë e noterit, në një moment të caktuar mund t'i ndodhë diçka noterit ose mund të arrestohet, ndërkohë që mund të ketë 10-15 kontrata me vlera të konsiderueshme. Si do të administrohen? Këtu duhet një rregullim ligjor se si do të veprohet për autoritetin dhe personin, sepse banka thotë se personi që ka të drejtë të autorizojë këtë llogari, nuk është. Pra, kjo duhet rregulluar me ligj.

Duke qenë se jam personi i ngarkuar nga Dhoma Kombëtare për përgatitjen e një sistemi elektronik, që duhet t'u shërbejë të gjithë noterëve, këtu bëhet fjalë për sistemin e noterit për noterin, shërbimet e noterit për noterin. Kjo nuk duhet keqkuptuar, sepse është sistem i Dhomës Kombëtare të Noterisë ose sistemi i noterit për noterin. Kemi ngritur një sistem. Noteria funksionon si sistem jo si individ. Është një shërbim që vazhdon në mënyrë të integruar për të gjithë kohën. Sot është një individ A apo B noter, kjo nuk ka rëndësi. Ajo funksionon si një e tërë dhe që të funksionojë si një e tërë. Në pikëpamjen formale, është organizuar në formën e piramidës prej Dhomës Kombëtare të Noterisë, që është autoriteti që ka për detyrë të kontrollojë, të administrojë dhe të bashkërendojë punën e të gjithë noterëve në vend. Në këto kushte, me detyrat që ka vendosur apo që kërkon ky ligj, me forcë disipline, ku dy anëtarë do të paguhet nga Dhoma e Noterisë dhe me një bord auditimi, që do të paguhet prej Dhomës Kombëtare të Noterisë, me Shkollë Trajnimi për Noterët dhe me trajnimin



vazhdues, me siguracionet e të gjithëve, kërkon një riorganizim dhe një ripozicionim të mirë të shërbimit të noterëve.

Në fund të fundit, aktualisht sot paguajmë ose duhet të paguajmë (kjo është për t'u diskutuar brenda grupit tonë), një tarifë vjetore 12 mijë lekë për Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe 6 mijë lekë për Dhomën e Noterisë.

Çfarë ka zgjidhur praktikisht për 24 vjet? Dhoma Kombëtare e Noterisë nuk ka një zyrë, nuk ka një organ funksional dhe të pagueshëm. Të gjitha veprimet dhe të gjitha përfaqësimet i bëjmë me paratë tona. Nuk po ankohe mi këtu për këtë pjesë, por ka ardhur koha që Dhoma Kombëtare e Noterisë të ulet në vendin e duhur dhe të vendosë rregullat e duhura, të cilat janë për të gjithë.

Është pasur parasysh ngritja e një sistemi që e tarifon noterin në bazë të volumit të punës. Kjo është si kosto individuale e secilit nga kostoja e përgjithshme. Ashtu siç noterit paguan qiranë e zyrës, pajisjet, rinovimin teknologjik, ujin, dritat, sigurimet shoqërore etj., paguan edhe shërbimin e kësaj. Jo vetëm thjesht e paguan, por mban funksionet e Dhomës dhe një sistem që mundëson ndërveprimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë me të gjitha institucionet e tjera dhe i jep një zgjidhje edhe problemit, që ka të bërë me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Në mënyrë automatike dhe pa dëshirën e noterit në momentin që akti arkivohet në zyrën e noterit, raportimi normal bëhet në Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Pra, në momentin që nënshkruhet akti dhe kalon për arkivim akti në zyrën e noterit, në të njëjtën kohë pa asnjë veprim tjetër nga ana e noterit dhe, nëse ky akt ka kaluar vlerën 1 milion lekë të rinj, siç e ka ligji, në çdo moment ky sistem është i adaptueshëm për çdo lloj ndryshimi ligjor që do të bëhet dhe bën raportimet normale.

Për sa i përket raportimit të aktivitetit të dyshimtë, kjo është një pjesë tjetër, që do ta shohim se si do ta zgjidhim me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Kjo pjesë nuk është objekt i kësaj.

Nëse ka ndonjë gjë tjetër.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Martini!

Do t'ju lutesha kolegëve të bënin pyetje shkurt, pa komente, sepse ka shumë noterë që kanë kërkuar fjalën

Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Martini, që u futët te pyetja që bëri kolegu Hyseni!

Edhe unë kam një pyetje në lidhje me sistemin elektronik. Ne jemi të detyruar që në kuadër të këtij ligji të reflektojnë edhe për raportin e MANIVAL-it, i cili do të bëhet publik

shumë shpejt, besoj brenda disa ditësh. Aty ka kritere strikte për rregullimin e ligjit të noterisë. Fati ynë është, që e kemi në dorë ligjin.

Aktualisht, cila është marrëdhënia e Dhomës Kombëtare të Noterisë me AKSH-in? Ku kanë akses noterët aktualisht? Deri në çfarë shkalle shkon ky akses?

Pyetja e dytë, ka të bëjë me një shqetësim tjetër që adreson MANIVAL-i në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave, por edhe të transparencës së të gjitha veprimeve. Sot ku mbahen arkivat? Kush i mban dhe për sa kohë i mban?

A ekziston mundësia që një noter (kërkoj ndjesë, se nuk dua të fyej askënd), t'i rikthehet një akti dhe të bëjë ndonjë ndryshim?

A ekziston mundësia të mbajë ndonjë vend bosh dhe të rifusë më vonë një dokument?

Ky është një shqetësim, që na është ngritur edhe në kuadër të vetingut, por është edhe një shqetësim i ngritur nga shumë qytetarë.

Faleminderit!

**Vasil Martini** – Po i përgjigjem pyetjes së parë. Për sa i përket raportit në Drejtorinë e Pastrimit të Parave, e thashë. Pjesa e parë është e zgjidhur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa i përket raportit, me AKSH-in. Aktualisht sot noterët operojnë me regjistrin noterial shqiptar, që është ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe ne nuk kemi ardhur këtu për t'u ankuar, por ka 1000 probleme pse nuk funksionon. Nuk do t'i them tani, por nuk i ka realizuar pritshmëritë e asaj që noteri t'i modifikojë dhe të jetë arkiv i integruar. Arkivi nuk është i integruar. Ne aktualisht, mund të hyjmë në platformën e AKSH-it për të marrë shërbime informacioni, por mund të hyjmë vetëm si vizitorë. E marrim informacionin siç është, *read only*, e pritojmë dhe e bashkëngjijmë, ndërsa platforma që kemi projektuar dhe kemi menduar të fusim i jep mundësi noterit nga një faqe (jo duke hyrë herë tek njëra dhe herë tek tjetra), të shfrytëzojë të gjithë platformën e AKSH-it dhe të ndërveprojë. AKSH-i është organi i licencues i nënshkrimit elektronik për noterin, kontrollues i kësaj korrektesie dhe nga ana tjetër, të jep mundësi në mënyrë interaktive, përmes platformës NISA, që të kalojmë në nivel operatori, jo të jemi thjesht vëzhgues. Duke dërguar elektronikisht kontratën në zyrën e regjistrimit, duke e kërkuar dhe duke e dërguar kontratën në mënyrë elektronike, bëhet regjistrimi në mënyrë elektronike dhe po në mënyrë elektronike, vjen konfirmimi që është regjistruar prona dhe në atë moment, po në mënyrë elektronike unë mund të disbursoj paratë në bankë pa dalë nga zyra e noterit dhe në radhë të parë, mendoj se kjo është me kosto zero për qytetarin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një moment!

E dyta, platforma është një arkiv i integruar.

Të shpjegoj edhe diçka tjetër. Platforma është një arkiv i integruar, që do të thotë se krijon një mundësi që qytetari nga shtëpia, për aktet që ka kryer në zyrën time, nëpërmjet certifikimeve të veta personale që akti ka, mund të shohë të gjithë informacionin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nëpërmjet *e-albania*-s te hapësira ime, kjo është pjesë që i shtohet asaj platforme dhe, në një farë kuptimi, është zgjatimi i saj. Një qytetar nuk ka pse të shkojë në Lezhë apo në Shkodër apo në Tiranë që të kërkojë noterin për të marrë kopjen.

Një mënyrë tjetër për të administruar në mënyrë integrale...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë, të gjithë jemi pranë një realiteti sot themi se kemi 470 noterë. Brenda 5-7-10 vjetëve do të bjerë numri në 200 noterë. Çfarë do të bëhet me arkivat e 270 noterëve, që nuk do të jenë? Kjo është një pyetje që nuk ka përgjigje sot. Është lënë në ligj që do të administrohet me udhëzime të ministrit të Drejtësisë, por ky është një problem shumë i rëndësishëm në pikëpamjen e marrjes së përgjegjësisë. Dhoma Kombëtare e Noterisë ka marrë përsipër ta menaxhojë këtë proces nëpërmjet ndërtimit të një arkivi dixhital, që është arkivi i noterit dhe sa kohë që është në punë, është vetëm e noterit dhe atë nuk mund ta administrojë askush pa lejen e tij. Kjo do të jetë e përqendruar dhe për këtë duhet një ambient i posaçëm, që do ta zgjidhë Dhoma Kombëtare e Noterisë.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Martini!

Në ligjin “Për noterinë” do të krijohet aksesimi për ndërtimin e kësaj platforme. Detajet e tjera të kësaj platforme, janë çështje të tjera. Ajo për të cilën ne jemi shumë të qartë te platforma, dhe këtë dua ta them para se t’ia kaloj fjalën noterit që e ka kërkuar, se reforma e dixhitalizimit të shërbimeve publike do të prekë edhe noterinë. Kjo është e qartë. Nëse platforma dhe zhvillimi i teknologjisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Ju nuk mund të jeni jashtë sistemit!

Nëse platforma teknologjike garanton privacinë e veprimtarisë noteriale, ajo platformë në këtë tryezë e ka marrë rrugën. Ne do të modernizojmë shërbimin publik noterial, siç kemi vazhduar të modernizojmë të gjitha shërbimet publike *One stop shop*, që u jepen qytetarëve në RSH. Kjo është e qartë. Nuk duhen detaje të tjera për këtë pjesë sepse ligji e

orienton dhe u jep mundësinë nënshkrimit elektronik dhe firmës elektronike. Këto zgjidh ligji. Detajet e platformave se me kë do të punohet dhe se si do të jetë platforma, sigurisht, këtë e zgjidh AKSH-i, Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Noterisë. Ne kemi vetëm një gjë në ligj: nënshkrimit elektronik dhe firmës elektronike. Kaq.

Urdhëroni!

**Hysni Ahmetaj** – Faleminderit për mundësinë që na dhatë për të bërë komente!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, prezantohuni!

**Hysni Ahmetaj** - Hysni Ahmetaj, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë. Unë kam probleme teknike në nenet 1, 2, 3 dhe 4. A mund t'i bëj komentet?

**Ulsi Manja** – Patjetër!

**Hysni Ahmetaj** – Objekti i ligjit rregullon dhe përcakton rregullat për ushtrimin e profesionit të noterit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të noterisë në RSH. E njëjta frymë vazhdon te neni 2, te neni 3 dhe te neni 4. Nuk përcaktohet se çfarë është noteri. Kemi komplet një tautologji: “Noteri është ai që kryen veprime noteriale. Veprimet noteriale kryhen nga noteri.”

Pra, së pari, nuk kemi një përkufizim se çfarë është noteri.

Pika e dytë, kam problem me objektin. Sigurisht, jam dakord të kemi një ligj të ri, por ky ligj i ri duhet të bëhet në frymën e reformës në drejtësi. Noteria nuk është pjesë e sistemit të drejtësisë, por është sistem ndihmës brenda vetë sistemit të drejtësisë.

Në të gjithë botën funksioni i noterit është garantimi i sigurisë juridike në transaksionet civile dhe veprimet e tjera juridike. Me këtë sy duhet parë. Sigurisht, është fakt i gjithëditur që siguria juridike është një nga plagët më të mëdha të këtij vendi për pjesën private. Noteri garanton sigurinë juridike, jep të drejtën private. Është fakt i gjithëditur që e drejta private ecën në dy shina: barazia juridike e palëve dhe liria kontraktore e palëve, që përjashton çdo gjë që ka lidhje me të drejtën publike.

Kur flasim për sigurinë juridike, flasim për diçka që nuk ka lidhje fare me sigurinë juridike të së drejtës publike.

Për mendimin tim, neni 1 duhet të përcaktonte qartë edhe kontrollin e cilësisë në ushtrimin e veprimtarisë së noterit. Kush do ta bëjë? Pra, nëse flasim për shtetin e së drejtës, këtu kam pakënaqësi dhe rezerva maksimale për misionin EURALIUS, i cili nuk është këtu si njohës së traditës sonë juridike, por është si ekspert i prezumuar i shtetit të së drejtës. Ai duhet të njoftonte që në fazat e para të hartimit të draftit, se shteti i së drejtës ashtu siç ka ndarje dhe balancim pushtetesh, ka edhe ndarje dhe balancim funksionesh.

Profesionet e lira sipas shteti të së drejtës rregullohen me dy lloj agjencish shtetërore. Janë funksionet politikëbërës që përfaqësohen nga ministri i Drejtësisë, i cili është një post politik, emëron dhe shkarkon vetëm funksionarët politikë dhe kemi edhe agjencitë rregullatore me të cilat ne dalëngadalë po e mësojmë traditën. I kemi quajtur fillimisht ente publike, sepse nuk kemi pasur një emër për to. As sot doktrina jonë, shkollat tona të jurisprudencës nuk e cekin fare se çfarë do të thotë “ent publik”, se nuk e dinë, sepse nuk kemi pasur traditë. Tashmë të gjitha agjencitë rregullatore i kemi ngritur me ujë, me drita me komunikim elektronik dhe postar, është e njëjta gjë.

Unë propozoj që bordi i disiplinës të jetë një institucion me kohë të plotë, nën mbikëqyrjen e parlamentit. Pra, ky ligj të rregullojë edhe mbikëqyrjen e disiplinës, jo vetëm organizimin, kontrollin e cilësisë dhe kjo të jetë një mbikëqyrje e pavarur, që varet vetëm nga parlamenti. Ky është kuptimi dhe funksioni rregullator i shtetit të së drejtës.

Nga ana tjetër, në çdo profesion të së drejtës tradita juridike është shumë e rëndësishme. Në profesionin e noterisë është thelbi.

Në Itali është ndryshuar ligji “Për noterinë” edhe para 2 vjetësh, në vitin 2016, por ligji në fuqi është i vitit 1913. Pra, siguria juridike, tradita juridike te noteri, është e jashtëzakonshme.

Sa i takon fjalës suaj për shërbimin ndaj qytetarëve, zoti kryetar i komisionit, ju informoj se ligji nuk ka prekur asnjë nga aktet që ligji ekzistues ka. Unë propozoj që të rikthehen në ligj të gjitha aktet noteriale të ligjit të vjetër, aktet që redakton noteri, dhe të shkruhet qartë nëse këto akte janë shteruese apo indikative në punën e noterit. Pra, noteri mund të bëj edhe diçka tjetër që këto nuk e kanë.

Mbikëqyrja e cilësisë është jashtëzakonisht e rëndësishme. Siguria juridike është garantuar ... Unë mendoj se një nga sistemet që ka funksionuar më mirë është noteria dhe kjo për shkakun se noterët janë persona fizikë, të cilët përgjigjen me pasurinë e tyre dhe me qenien e tyre fizike përballë qytetarit.

Së dyti, noterët kanë konkurrentë njëri-tjetrin dhe nuk ju pëlqen kur konkurrojnë në mënyrë të paligjshme. Të dyja këto, ne e njohim mirë mentalitetin shqiptar, kanë ndërtuar një traditë, që unë mendoj se është pozitive.

Nëse marrim shembull dëshmitë e trashëgimisë, është e pakrahasueshme siguria ligjore që ka dhënë dëshmia e trashëgimisë e dhënë nga noteri krahasuar me dëshminë të trashëgimisë të dhënë nga gjykata. Këtë mund ta matim me statistika: sa akte trashëgimie të lëshuara nga noteri paditen në gjykatë dhe sa akte janë apeluar nga vendimi i gjykatës. Janë të

pakrahasueshme. Kjo për shkak se noteri është person fizik që përgjigjet personalisht me pasurinë dhe integritetin e vetë përball klientit që shkon në zyrë.

Tashmë këtu është ndërtuar një traditë dhe unë mendoj që ne duhet ta konsolidojmë këtë bazuar në shtimin ... Ajo që ju thoni, kryetar, që neve nuk na duhet noteri, nuk është e drejtë. Noteri ushtron profesionin. Të ndërtohet një sistem i mbikëqyrjes së cilësisë së noterëve, sepse po cenohet siguria juridike më shumë nga cilësia sesa nga shkelja e ligjit. Duke qenë se e drejta private është e pafundme, mjafton që palët të mos shkelin ligjin. Duke qenë se i gjithë shteti ynë është në një proces reformash administrative, institucionformues, si të doni quajeni, ne çdo ditë përballemi me boshllëqe ligjore, vakuum, me dispozita bivalente, të cilat kanë kuptime ambige. Ne bëjmë si ...

Unë prisja nga Dhoma të na thuhej se ... Ne kemi bërë disa herë mbledhje dhe ka praktika juridike, të cilat, edhe pas një mbledhjeje të stërgjatë dhe një debati shumë të madh ne nuk kemi dalë dot me konkluzionin se si ta zgjidhim, sepse nuk ka rregullim në ligj. Secili ka bërë në kokën e vet, por kjo dëmton sigurinë juridike.

Nga ana tjetër, edhe për shkak të traditës sonë, që noterët i licencon ministri dhe betohen para ministrit, por edhe për shkak të ndarjes së funksioneve *check and balance*, që asnjë institucion të mos ketë të drejtë dhe interes të pushojë një noter nga puna për të futur tjetrin, unë propozoj që procedura e tyre të rrijë siç është te ministri i Drejtësisë. Noterët le të betohen edhe simbolikisht te ministri i Drejtësisë, sepse është tradita jonë. E gjithë procedura e disiplinës dhe kontrollit të cilësisë le të kalojë nga bordi. Tre anëtarët e bordit, që në ligj është përcaktuar të propozohen nga ministri i drejtësisë, të votohen në parlament, kryetar, kurse pagat e tyre të paguhen nga kuotat e anëtarësisë. Shteti të mos e fusë dorën në xhep.

Për sa i takon kontrollit të cilësisë, bordi të ketë kompetencën të ndërtojë edhe standarde cilësie. Për shembull, një kompani me vulën e vet autorizon një person të kryejë një veprim në emër të kompanisë. Ka gjyqtarë që e njohin këtë lloj prokure, por ka edhe gjyqtarë që nuk e njohin, ka noterë që e njohin, por ka edhe noterë që nuk e njohin. Kush do ta ndajë shapin nga sheqeri? Kush do ta unifikojë praktikën? Le ta bëjë bordi dhe të kontrollojë zbatimin e saj.

Është futur në ligj teksti: “ai zhvillon takime”. Unë mendoj se këto nuk janë procedura dhe duhet të hiqen, sepse ligji përcakton rregullat dhe parimet kryesore. Sa më shumë të komplikohet në procedurat që janë futur këtu, me shkollat dhe trajnimet ...

Ne nuk mund të bëjmë një shkollë ku të gjithë fshatrat e Shqipërisë të çojnë fëmijët të studiojnë për t’u bërë noterë, ndërkohë që për dy vjet rresht nuk do të shtohet një noter i vetëm. Sa më shumë të komplikohet kjo procedurë, aq më shumë do të shtohen mundësitë e abuzimit.

Së dyti, i vetmi përcaktim perfekt që gjej te këto nene të ligjit është që Dhoma Kombëtare e Noterisë është organizatë profesionale. Termi “organizatë profesionale” në doktrinën juridike është i shtetit të së drejtës dhe këto organizata profesionale gjithmonë rregullohen nga agjenci rregullatore që janë të pavarura nga agjencitë politikbërëse. Ministri është person politikbërës. Ministri nuk shkarkon dot sekretarin e vet, sepse është pjesë e administratës publike, por shkarkon noterë kur të dojë.

Vetë ju, kryetar, sapo u acaruat nga përgjigjet e *e-mail-eve*, thatë se ka noterë, bazuar në përgjigjet dhe komentet që të kanë ardhur për ligjin, që nuk e meritojnë të jenë noterë. Zot na ruaj, sikur të jetë duke na dëgjuar ministrja e Drejtësisë, që unë po kërkoj t’i hiqet kompetenca e masës disiplinore, dhe të më heqë licencën nesër. Kaq e thjeshtë në pikëpamjen figurative. Kush e ndalon të më heqë licencën? Unë mendoj ndryshe dhe po flas si jurist.

Për ta mbyllur, jam i gatshëm të ofroj kohë pa fund për të ndihmuar këdo që t’i artikuloj mendimet e mia sa më saktë, sepse i rashë shumë shkurt.

Së fundi, gjithë kjo koklavitje, Dhoma Kombëtare e Noterisë nuk funksionon.

Ka noterë që dalin në pension dhe askush nuk ua merr dot licencën. Nuk funksionon as ministri, sepse nuk funksionon mbikëqyrja me persona individualë. Ministri është një individ që mund t’i gjendet miku. Nëse po flasim për shtetin e së drejtës, unë do e mbaja licencën. Nuk funksionon. Në Tiranë jemi gjysma e noterëve të Shqipërisë dhe ne e dimë kush e shkel nga pak dorën. Ne të parëve na intereson që askush të mos e shkelë dorën. Ku të ankoresh? Dhoma nuk e ka për kompetencë këtë. Nuk ekziston ministër në botë, gjatë gjithë këtyre agjencive dhe politikave që do të hartojë vetë si ministër, inspektimeve që do bëj, të bëj edhe inspektimin e sistemit të noterisë, por edhe funksionet rregullatore. Nuk del kohë fizike për asnjë person që ekziston në tokë. Inspektimet dhe kontrollat të rrinë siç janë me gjithë emërimin e ministrit të Drejtësisë, kurse bordi i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të cilësisë të varet nga parlamenti: dy vetë nga Dhoma e Noterisë, tre nga parlamenti. Aty t’i bëhet gjyqi noterit ku të drejtë të ankohet çdo palë private dhe çdo noter për njëri-tjetrin, ku Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe dhomat rajonale të përfaqësojnë interesin kolektiv të noterëve dhe, ministri i Drejtësisë, në çdo rast, përveç të drejtës së vet për të bërë inspektime kryesisht kur t’i teket, të përfaqësohet edhe në bordin e etikës me propozime për standarde dhe masa disiplinore, sepse përfaqëson aty interesin publik. Të shkruhet në ligj që interesin publik e përfaqëson ministri, kurse agjencia rregullatore merr masat.

Kështu siç është situata nuk funksionon. Përballë kam nënkryetarin e Dhomës së Noterëve. Presidentja foli për sistemin ADISA. Dua ta ndaj me ju, kryetar, sepse nuk është kaq e thjeshtë që ju të mos merreni me noterin. Ju duhet të merreni me gjithçka, sepse e drejtoni

politikisht këtë vend. Zotëria foli po për sistemin ADISA. Ju informoj zyrtarisht se ne jo vetëm jemi pjesë e reformës dixhitale, kryetar, por jemi të privilegjuar. Gjithçka që prodhon sistemi ADISA, unë e prodhoj nga zyra ime me një password që më ka dhënë vetë AKSHI, si nëpunës qeveritar. Jam i privilegjuar. Unë i nxjerr vërtetimin e pensionit dhe çdo dokument që nxirret online sot gjithkujt në këtë vend, mjafton të më japë numrin personal. Unë kam akses në Regjistrin e Gjendjes Civile, kryetar, në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, në Regjistrin e Makinave, në të dhënat e personave pronarë në QKB. Çdo të dhënë që mua më duhet për qarkullimin civil unë e kam në sistem. Tani na del një projekt, që propozohet si modë, zhvillohet si fantazi inxhinierike, bëhet një mbledhje dhe nuk thuhet se kjo koston. Të nesërmen nënkryetari i Dhomës Kombëtare të Noterisë e ka shpallur publikisht në media se ky projekt kushton 8 milionë euro dhe pas kësaj, kolegu i tij na thotë se ky sistem nuk është për qytetarët, por për noterët dhe i noterëve. Barazimi është: 8 milionë euro pjesëtim 470 noterë = 17 290 euro. Ku do t'i marr unë këto?

Pyetja tjetër që kam për nënkryetarin është: ku e gjen të drejtën një organizatë profesionale të taksojë? Taksat në këtë vend nuk i vendos dot qeveria pa ia dhënë parlamenti të drejtën. Eurobondet i nxjerr në parlament, Dhoma Kombëtare akaparon 8 milionë euro projekt, që do të na i marrë nesër vetëm për ne dhe sistemi është i yni, sepse unë nuk do të hap njëherë regjistrin e automjeteve dhe njëherë regjistrin e tokave, por po u futa këtu do t'i hap menjëherë. E kuptoni çfarë po ndodh? Duhet një mbikëqyrje e centralizuar *full time* e parlamentit. Aty të atashohen të gjitha bordet e auditit, të cilësisë, le të ndërtojë standarde, kurse ligji të caktojë vetëm parimet, përndryshe, njëri i bie gozhdës, tjetri patkoit. *E-mail*-et që ju kanë ardhur juve nuk janë çështje grupesh, apo çështje politike, kryetar, por gjithsecili ka sensibilitetin e vet. Dikush e shikon më gjatë, dikush më shkurt, dikë nuk e mbajnë nervat. Dikush ka ardhur në mbledhje këtu, ka kalitur veten, ka pirë kamomil, duke thënë ishalla s'po përplasem me njeri. Si të më mbajnë nervat mua kur t'i më thua që do të marr 17 mijë euro se është sistem për ty. Ti nuk e do, por nuk ka rëndësi, ta jap unë. Unë po të pyes ku e gjen të drejtën ligjore ta bësh këtë? Ligji nuk e ka të rregulluar në funksionin rregullator me politikbërës.

Kaq kisha.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Po, zonja Sadushi!

**Mimoza Sadushi** - Më falni, sepse ndoshta të gjitha janë keqkuptuar.

Për sa i përket sistemit, që ne e kemi marrë si model nga Gjermania, Austria dhe të gjitha vendet europiane, jemi endet në fillimet e tij. Në mbledhjen e Tiranës unë ju thashë që



jemi ende në fillimet tona dhe çështja është nëse do të arrijmë dot ta bëjmë apo jo sistemin. Asnjë institucion nuk ju lëshon kompetenca, përkundrazi, do të kërkojnë t'ju marrin kompetenca.

Jo më larg se para një jave isha në Itali në Kongresin e Noterëve Italianë. Tema e kongresit ishte: Thjeshtësia dhe Inovacioni. Do të thotë që ata kanë dixhitalizim dhe kërkojnë ta zgjerojnë dixhitalizimin. Në kongres u paraqit si sfidë ndryshimi i ligjit. Nuk ecet më me ligjin e vitit 1913, – thanë noterët italianë. Dua t'ju citoj shprehjen e Presidentit të Komisionit të Noterëve të Vendeve të Bashkimit Europian, i cili tha: “Direktivat europiane për noterët janë që brenda gjysmë dite të krijojmë dhe regjistrojmë shoqërinë, që brenda gjysma dite të shesis shtëpinë”. Pra, ne nuk mund të themi nëse do të ketë ndryshime apo jo, dryshimi është, nuk mund të themi nëse do të kemi sfida dhe do t'i pranojmë apo jo, sfida është.

E gjithë Europa dhe të gjitha dhomat kombëtare të vendeve të Bashkimit Europian kanë sistemet e tyre. Ideja është që në të ardhmen të krijohet një regjistër ndërkombëtar testamentesh, një regjistër ndërkombëtar i dëshmimeve të trashëgimisë, një regjistër ndërkombëtar i revokimit të prokurave, sepse edhe sot ne bëjmë shitje me prokura italiane dhe nuk e dimë nëse është revokuar apo jo. Pasojat i ka qytetari.

**Ulsi Manja** – Nuk ka debat për këtë pikë. E the mendimin tënd, zoti Ahmetaj.

**Mimoza Sadushi** – Ideja është që ky sistem do t'u shërbejë më shumë qytetarëve sesa noterëve. Në qoftë se qytetari do të vijë në zyrën tënde, do të vij vetëm një herë. Do të firmosë kontratën dhe do të vij të marrë vetëm certifikatën. Pra, t'i do t'i bësh kontratën, do t'ia çosh elektronikisht në zyrën e regjistrimit dhe do të vij po certifikata elektronikisht. Në rast se nuk do ta bëjmë ne me firmën elektronike, do ta bëj AKSHI nesër. Do ta bëj ADISA kontratën e shitjes së apartamenteve. Po ta deklaroj këtu.

Në rast se ne nuk bëjmë shitjen e makinave me sistemin tonë, në vitin 2019 fillon me firmën elektronike Drejtoria e Përgjithshme e Shitjes së Automjeteve.

Kam të drejtë, zonja Hysi?

Njeriu bën një llogari në shtëpinë e tij, ashtu siç duhet ta bëjmë ne. Unë do të harxhoj pesë lekë dhe do të fitoj 10 lekë apo do të harxhoj 10 lekë dhe të mos marrë asgjë? Kjo është llogaria që kemi bërë ne si Dhomë Kombëtare e Noterisë.

Përpyekja jonë maksimale ka qenë që noterët të mbajnë kompetencat që kanë. Po nuk i mbajtëm dot dhe po nuk bëjmë këtë sistem, ne nuk do të kemi më kompetenca. Të gjithë do të bëjmë vetëm prokura për gjyq.

Kaq kisha për të thënë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Nuk jemi mbledhur këtu se si ...

**Hysni Ahmetaj** – Po abuzohet. Nuk ka direktiva të drejtës së europiane për noterinë, kryetar.

**Ulsi Manja** – Zoti Ahmetaj, BE-në e kemi në krah.

**Hysni Ahmetaj** – Unë kam studiuar në BE, në Austri, për këtë punë.

Ta gjej EURALIUS-i.

**Ulsi Manja** – EURALIUS-i është në Shqipëri për një projekt shumë më madhor sesa ligji i noterisë. Sigurisht që ka të gjithë respektin dhe falënderimet tona edhe për kontributin që jep, sepse po na sillni këtu modele Itale, Spanje, Gjermanie. Jo, jo Kuvendi i Shqipërisë ka Shërbimin e Kërkimit Parlamentar dhe ne e dimë në detaje si funksionon shërbimi i noterisë në Europë. Absolutisht.

Platforma nuk është thelbi i ligjit. Nëse ju keni ardhur për hallet tuaja, është tjetër gjë.

**Hysni Ahmetaj** - Theli i ligjit është kompetenca për të akapuar 8 milionë euro? Dua përgjigje, kryetar.

**Ulsi Manja** – A ka mundësi të fokusohemi tek ato probleme që ka ligji?

E nisët shumë mirë me diskutime juridike për problemet që ka ligji në raport me Kushtetutën dhe Kodin Civil, të tjerat janë probleme që do t'i rregullojmë siç kemi nisur reformën e dixhitalizimit të të gjithë shtetit shqiptar.

Ju e konsideroni veten sikur me zor po rrini në shërbimin e noterisë. Këtu duket sikur shteti mezi po ju mban se mos ju braktisni profesionin. Jo, jo, jeni vula e shtetit në territor, ofroni një shërbim publik të deleguar, por është shteti ai që vendos se deri në çfarë mase, si, dhe ku do ta ofroni këtë shërbim. Absolutisht. E bëme ligjin e avokatisë, që u shërben qytetarëve dhe avokatëve, dhe patëm një bashkëpunim perfekt me 10 mijë avokatë që ka Shqipëria. Këtu ju thoni që mezi po rrini në profesion. As ne nuk jemi me zor deputetë. Kemi pranuar të vijmë këtu. Jemi votuar dhe kemi pranuar. Ju madje keni bërë sakrificë të panumërta për t'u bërë noterë. Kur vjen puna të bëjmë një ligj që të harmonizojmë siç duhet veprimtarinë noteriale, noterin, interesin publik dhe cilësinë e shërbimit, tentohet të katandiset debati për një platformë elektronike, që duhet të jetë në plan të dytë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lëri eurot. Nuk më kompleksoni me eurot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem, është çështje tërësisht dytësore. Absolutisht. Për sa kohë ky parlament ka votuar ligjin për nënshkrimin elektronik dhe firmën elektronike, qytetarët do të duhet t'i marrin shërbimet ashtu siç ka votuar parlamenti. Rrugët se si do të bëhet do të shikohen, prandaj ka

organizim dhome. Me sa shikoj, ju nuk doni organizim dhome, por secili të jetë dhomë më vete. Ju lutem, flisni për debatin teknik, problemet juridike që ka ligji në raport me Kodin Civil, Kushtetutën e kështu me radhë, për të tjerat e vendosim ne, të marrim edhe ekspertizën e EURALIUS-it, sigurisht për këtë pjesë.

Ka kërkuar fjalën zonja Bernhard.

**Agnes Bernhard** – *(përkthen përkthyesi)* Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të përqendrohem vetëm në disa aspekte. Do të theksoja që profesioni i noterit është një institucion publik dhe noterët janë nëpunës publikë, të cilët janë të pajisur në bazë të akteve juridike me funksione të caktuara. Këtë duhet të kemi parasysh kur shikojnë profesionin e noterit. Kjo e diferencon noterin nga të gjithë shërbimdhënësit e tjerë. Si në çdo sistem tjetër noterët kanë privilegje të rëndësishme, do të ishte e pakuptueshme që ky nocioni i këtyre privilegjeve të ofrohej duke mos pasur parasysh kriteret më të larta dhe objektivin. Kjo e dallon atë nga një ndërmarrje e vogël ose familjare, e cila trashëgohet nga një gjeneratë tek tjetra. Duke qenë se ushtron një funksion shtetëror publik është e paimagjinueshme që profesioni i noterit të trashëgohet bazuar në marrëdhënie gjinie sikur të ishte një mall, që mund të shitej tek ai që ofron më shumë ose t'i jepej atij bazuar mbi preferenca profesionale. Kjo është në kundërshtim me çdo parim të ushtrimit të funksioneve publike. Nëse e shtrijmë pak më tej do ta krahasonim ndoshta me trashëgiminë ose dhënien pas të profesionit të gjyqtarit ose të prokurorit me pasardhësit. Nëse i kthehemi ligjit italian ata e quajnë kompeticion. Noterët emërohen, pasi kalojnë një provim shumë të vështirë dhe pastaj titulli jepet në bazë të rezultateve të provimit. I vetmi vend ku ka mbeturina të këtij sistemi të trashëgimisë është Franca, ku noterët kanë të drejtën për të propozuar pasardhësit e tyre, kjo referuar anëtarëve që janë të kualifikuar, por kjo tashmë është në procesin e përfundimit, të daljes nga fuqia dhe konsiderohet si shumë problematike dhe politikisht është diçka që nuk mund të përfaqësohet. Ne besojmë se kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohet si shembulli i një praktike më të mirë. Mund të shpjegohet vetëm me traditën, me të shkuarën. Pra, është e vështirë për ta tejkaluar këtë, sepse ekziston prej 200 vjetësh, por po i vjen fundi dhe natyrisht nuk është e pranueshme në shekullin XXI. Është në mospërputhje me parimet etike të Unionit Kombëtar të Noterëve, ku thuhet se noteri duhet të bazohet gjithmonë mbi kriteret profesionale dhe objektive, gjithashtu edhe në lidhje me nenin 72 dhe për kufirin e sasinë së parave të cilat mund të dorëzohen kesh. Ky është një rekomandim që vjen nga *MONEYVAL*-i, i cili rekomandon të mënjanohet në maksimumin e mundshëm paraja në dorë për të mënjanoar edhe pastrimin e parave. Duke pasur parasysh funksionin e noterit si një funksion publik, këto kufizime nuk janë të zbatueshme për një profesion të tillë.

Dua t'ju falënderoj për kontributet e vlefshme që dhatë sot! Kam besimin, jam e bindur se këto kontribute do ta përmirësojnë projektligjin dhe parlamenti do të jetë në gjendje ta miratojë një ligj të tillë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Bernhard!

Ka komente?

**Gelanda Shkurtaç** - Faleminderit!

Kam dy gjëra të shkurtra.

**Ulsi Manja** - Më falni që po ju ndërpres!

E kemi nisur këtë mbledhje që në orën 11:00, tani edhe koha bën të veten, prandaj do t'ju lutem që të flisni shkurt, të mos përsërisim njëri-tjetrin dhe të bëhen ndërhyrje vetëm për nene, për të cilat nuk është diskutuar ende.

**Gelanda Shkurtaç** - Zoti Manja, ne jemi shumë dakord me politikën që të bëhet një ligj i ri.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Ju lutem shkurt për ligjin!

**Gelanda Shkurtaç** - Më vjen mirë që zonja Bernhard përsëriti faktin që noteri është funksionari më i lartë publik dhe duke qenë i tillë, së pari është e drejtë apo jo, këtë pyetje jua drejtoj ju zonja Hysi, nuk po i hyj çështjes së trashëgimisë, sepse për hir të së vërtetës është një debat që u krijua nga risia që solli ligji i ri, pasi ligji i vjetër, në asnjë vend nuk thoshte se patjetër fëmija i noterit duhet të bëhet i tillë.

Kolegë, më korrigjoni! A ka qenë kështu? Atëherë pse ligji i ri e futi këtë element duke e përcaktuar? Në ligjin e vjetër nuk na rezulton kjo. Le të qëndrojnë dispozitat siç ishin. Në ligjin e vjetër në asnjë vend nuk thoshte se fëmija i noterit duhet të bëhet noter, gjithkush bënte provimin.

Edhe pyetja e dytë, është për ju zonja Hysi. Jemi shumë dakord që do të dixhitalizohet, sikurse është dixhitalizuar. Jua bëj pyetjen në cilësinë e një notereje të thjeshtë të një zone të caktuar. Ju lutem, cili do të jetë raporti midis RNSH-së, NISA-s që është një regjistër i administruar nga Ministria e Drejtësisë, ku do të përplaset noteri në RNSH, në NISA-s? Sot unë nuk kam një qëndrim nga Ministria e Drejtësisë që organi politik, të më thotë se çfarë do të bëj si notere, kur ekzistonte një RNSH, do të vihej një NISA-s, është një formë e integruar e së parës?

E fundit, duke qenë se noteri është një funksionar publik, më lejoni zonja Sadushi, jua kam thënë edhe në mbledhje, nuk mund të lidhemi në një projekt të BE-së që kushton 8

milionë në cilësinë e një organizate *non profit*. Janë dy vendime të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe GJEDN-së që Dhomës Kombëtare të Noterëve i ka thënë: “Ju nuk jeni Dhoma e Avokatëve, ju jeni funksionarët më të lartë publikë. Nuk mund të merrni vendime në palë të treta sikur të jeni privatë”.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Po, zonja Sadushi.

**Mimoza Sadushi** - Më fal, t'ju sqaroj edhe njëherë!

Ende nuk e kemi bërë lidhjen me palët e treta, sepse kontrata ende nuk është bërë. Jemi ende në diskutime. Dhoma Kombëtare ka një Asamble Kombëtare, që është organi më i lartë vendimmarrës dhe ky vendim është marrë në Asamblenë Kombëtare.

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Zonja Sadushi, a ka mundësi të mbyllni mikrofonin! Mos më bëni të përsëris ato që tha kolegu Fino!

Zonja Sadushi, unë i kuptoj tani qëndrimet. Pasi të miratojmë ligjin e ri dhe të dalin organet e reja secili sipas fuqisë që do t'i japë ligji, mund të organizohet te Dhoma.

Ju lutem! Do të flasim të gjithë. Kini pak respekt. Kemi edhe kryetarin e Dhomës së Korçës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos qëndro aty, se edhe ju përfaqësoni një Dhomë të Noterëve.

Shqipëria është e madhe fillon nga Vermoshi deri në Konispol.

Edhe nëse Dhoma e Tiranës është Dhoma më e madhe, ju që punoni dhe ofroni shërbime nëpër rrethe meritoni të gjithë respektin tonë: Korça, Vlora, Shkodra, Durrësi dhe të gjitha me radhë, sepse qytetarë jetojnë atje, qytetarë jetojnë në Tiranë.

Dua të dëgjoj kryetarin e Dhomës së Korçës, të Shkodrës, të Durrësit dhe të Vlorës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

I kemi thirrur kryetarët e Dhomave këtu dhe nuk po u japim të drejtën për të dhenë mendimin e Dhomave të tyre.

Zoti Ruvina, kryetar i Dhomës së Noterisë së Korçës.

Do t'ju lutem të flisni shumë shkurt për projektligjin.

**Stavri Ruvina** - Faleminderit, zoti kryetar që më dhatë fjalën!

Si përfaqësues i Dhomës së Noterëve të Korçës, dua të them se para 4 ditëve kemi diskutuar nën për nen projektligjin “Për noterinë”, i kam sjellë edhe me shkrim mendimet që kanë nxjerrë edhe kolegët e mi të Korçës. Nuk e di nëse është e drejtë apo jo, por shumë

herë kolegët mundohen të fshehin atë pjesë që na preken interesat, sidomos për sa i përket nenit 8 që ka projektligji i ri “Për noterinë”. Po shpreh edhe mendimin e noterëve të Korçës. Nuk e di se ku do të jetë e keqja nëse do të ekzistojë përsëri neni 22 i ligjit të vitit 2004, ku bashkëshortet dhe fëmijët jo se u ligjërohet trashëgimia, se këtu nuk shikoj asnjë fjalë “trashëgimi”, por fjala “i ofrohet”. Pra, ku do të ishte e keqja nëse do të qëndronte përsëri kjo fjalë? Është një fjalë shumë evazive. Fjala “i ofrohet” nga Ministri i Drejtësisë, mund edhe të mos i ofrohet. Nuk e kuptoj se ku është e keqja? Si një noter që kam një eksperiencë gati 18 - vjeçare jam personalisht i mendimin që ky ligj të qëndrojë, ose më saktë e drejta e ofrimit nga ministri i Drejtësisë të bashkëshortit dhe fëmijëve, nëse ata të fitojnë 80%, kuptohet si të gjithë shtetasit e tjerë.

**Ulsi Manja** - Ky është mendimi. Po për nene të tjera?

**Stavri Ruvina** - Neni 8. Koncepti i Dhomës së Noterit për ne si Dhomë nuk sjell asnjë risi. Nuk e di se, cila notere e ka kërkuar nevojën e një zëvendësnoteri. Nuk besoj të ketë noterë në Republikën e Shqipërisë që të kenë nevojën e një zëvendësnoteri në zyrë.

Ka edhe probleme të tjera që u trajtuan për sa u përket masave disiplinore që do të kryejë noteri. Nëse kryen një vepër penale, afati i parashkrimit është 10 vjet. Si mund të jetë afati i parashkrimit 10 vjet për një masë disiplinore?

**Ulsi Manja** – Anëtarët e Komisionit të Ligjeve, janë të gjithë juristë me eksperiencë.  
*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Ruvina, e vetmja gjë e re që keni thënë deri tani është se ka noterë që kanë mbushur moshën për pension dhe vazhdojnë të ushtrojnë profesionin. Të gjitha të tjerat, qoftë me moshën apo 10 vjetët e pezullimit, të jeni të bindur se e kanë draftin të kopsitur si më i miri, sepse kjo mund të jetë tryeza e 20-të që organizojmë njëri me tjetrin këtu.

Ju lutem, mos bini në përsëritje!

**Stavri Ruvina** – Meqenëse këmbëngulni, unë do të përqendrohem më tepër te trashëgimia e profesionit dhe trashëgimia e zyrës noteriale. Unë kam pasur fatin e mirë, që të trashëgoj një arshivë të vjetër të qytetit të Pogradecit që u përket, këtë mund ta thotë edhe zonja Hysi, akteve noteriale të përpiluara që nga viti 1943, si regjistër i veprimeve noteriale. Por defekti është se shumica e akteve të atyre viteve nuk figurojnë për arsyen e thjeshtë se noteri që i ka trashëguar, kur noteria ka qenë shtet, nuk treguar përkujdesjen e duhur për t'i ruajtur. Dua të tregoj një fakt: nuk ka krenari më të madhe për profesionin e noterit, nëse ai gjen një akt të vjetër, siç konsiderohet një akt mbi pesëdhjetëvjeçar.

**Ulsi Manja** – Po pra, por cili është sugjerimi juaj për arkivin? Sepse ne jemi shumë të interesuar për arkivin, që ta dini ju.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Stavri Ruvina** – Ashtu siç mund ta trashëgojë bashkëshorti apo fëmija arkivin noterial të paraardhësit të tij, nuk mund ta trashëgojë kurrë një noter.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Në rregull! Këtë e morëm vesh.

**Stavri Ruvina** – Ka disa nene, në të cilat janë përsëritur të njëjtat gjëra, gjë që mund të kapet shumë thjesht.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa i përket nenit 125, deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia mund të hartohet dhe vetëm nga një noter i njësisë vendore, kur lëshohet dëshmia e trashëgimisë, por kjo kompetencë mund t’u kalojë të gjithë noterëve. Nuk e di nëse do të ishte e pranueshme, për të vetmin fakt se trashëgimtarët mund të paraqiten aty ku banojnë vetë dhe jo ku i është bërë dëshmia e trashëgimisë ligjore. S’ka pse të përjashtohet, nëse dëshmia e trashëgimisë ligjore i është bërë në Korçë, ndërkohë që trashëgimtari ligjor, që mund të jetojë në Tiranë, duhet të shkojë detyrimisht në Korçë për të bërë heqjen dorë, kur mund ta bëjë edhe në Tiranë. ka të njëjtën vlerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, ju lutem!

**Stavri Ruvina** – Janë pothuajse të njëjtat çështje, që i prekën edhe kolegët, edhe presidentja. Unë i kam me shkrim dhe do t’i dorëzoj.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

**Stavri Ruvina** – Faleminderit edhe juve!

**Ulsi Manja** – Ato që keni me shkrim mund të na i dorëzoni.

Dhoma e Vlorës.

**Vezire Dushi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të noterëve të Vlorës, po të atyre që kanë paraqitur vërejtje, unë mendoj se, pak a shumë, këtu u thanë të tëra. Meraku im nuk qëndron te fakti i noterit trashëgimtar, pasi mendoj se do të ketë një rregullim ligjor, që fëmijët e noterëve, që kanë qëllim të bëhen noterë, do të futen në konkurs. Pavarësisht se kush janë, ata do të konkurrojnë njëlloj si të tjerët. Nëse ata do të jenë të aftë ta marrin, le ta gëzojnë e ta trashëgojnë. Këtu nuk kemi trashëgimi.

Problemet i shoh më tepër te profesioni ynë si noterë, kryesisht te dëshmitë e trashëgimisë ligjore e testamentare, sepse aty kemi përplasje te neneve. Diku kemi tek heqja dorë nga trashëgimia, diku kemi rastin kur lëshohet dëshmia e trashëgimisë dhe pastaj hiqet dorë, që tekefundit është ligjore. Do të lëshoj dëshminë, që të them: hoqa dorë. Jo pa dëshmi.

Në praktikë kemi parë, te disa noterë të caktuar, edhe në Vlorë ka pasur raste, kur edhe pa u bërë trashëgimtar – sepse ti nuk e di ende se sa e ke pjesën në trashëgimi, për sa kohë që dhoma nuk të ka përcaktuar si noter – ke hequr dorë. Si ke hequr dorë? Në çfarë pjese ke hequr dorë? Besoj se këtu duhet të ketë një rregullim.

Po kështu edhe te kushtet edhe te kushtet e rezervës ligjore. Në qoftë se e keni parasysh...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në qoftë se e keni parasysh, te “Kushtet e rezervës ligjore” kemi moshën e përcaktuar, 55 për gratë, sipas Kodit Civil, dhe 60 për burra. Kjo bie në kundërshtim me ligjin “Për sigurimet shoqërore”, pasi sot mosha e pensionit është rritur. Si mund të quhet e paaftë një grua 55 vjeçe, për të trashëguar.

**Ulsi Manja** – Si t’ia vëmë bravën derës?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Veziro Dushi** – Në qoftë se do të flasim për testamentet e bëra në Shqipëri dhe testamentet e bëra jashtë vendit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe te 130-a e kemi.

Si do të veprohet në rastet e testamenteve? Mendoj se kjo duhet të rregullohet me ligj. Testamente që janë bërë në Shqipëri dhe do të çelen jashtë shtetit, dhe testamente që janë bërë jashtë shtetit do të çelen në Shqipëri. Procesverbali i çeljes së testamentit. Në praktikë na ndodh që, për shembull, vjen një zyrë përmbarimi dhe thotë: më jep një çikë procesverbalin e filanit. Ne themi se zyra e përmbarimit ka interesa, ndaj ne, me kërkesa e me gjëra të tjera do t’i rregullojmë këto punë, por pa u çelur procesverbali, si do të vazhdojmë të quajmë trashëgimtar testamentar X person? Mendoj se këtu duhet të ketë rregullim.

Si do të jetë testamenti që do të na vijë nga jashtë shtetit, për t’u çelur në Shqipëri? Sepse, duke qenë se ne e kemi andej gjysmën e popullsisë, do të lëshohet një testament, do të jetë edhe pasuria andej, edhe pasuria në Shqipëri. Si do ta kërkojë noteri?

Mendoj se këto janë gjëra praktike, të cilat duhet të rregullohen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Veziro Dushi** – Diçka tjetër: kemi kryerjen e veprimeve jashtë zyre. Një vërtetim nënshkrimi, një veprim të kryer jashtë vendit, a duhet ta bëjë noteri apo nuk duhet ta bëjë? Sepse ka disa prokura të kryera nga noterë të veçantë, jashtë vendit, që gjykata i pranon, por ka prokura të tjera që gjykata nuk i pranon.



Kam një merak, i cili lidhet prapë me dëshmitë e trashëgimisë. Kush do ta bëjë pavlefshmërinë? Do ta bëjë noteri apo gjykata? Duhet të përcaktohet, sepse themi: noteri e nxjerr të pavlefshëm një testament, dhe gjykata e nxjerr të pavlefshëm një testament.

Për sa kohë që ne shprehemi për rezervën ligjore, i bie që një pjesë e të testamentit apo gjithë testamentin ta nxjerrim të pavlefshëm, ndërkohë që është gjykata ajo që gjykon në nëpërmjet aktit që nxjerrim nga dora.

Këto kisha unë. Ato të tjerat janë të diskutuara dhe të rregulluara.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Debati ia vlen, sepse ky është thelbi i ligjit: si të rregullojmë veprimtarinë noteriale në drejtim të aktit noterial dhe të veprimtarisë tjetër që ka noteri, sa i takon cilësisë së shërbimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Martini, të lutem, se kam kryetarët e dhomave në linjë.

Tani e ka fjalën zoti Klement Radovani, i Dhomës së Noterisë Shkodër.

**Klement Radovani** – Faleminderit për ftesën!

Edhe Dhoma e Noterëve Shkodër, në kuadër të njohjes me projektligjin “Për noterinë”, më datë 16 ka organizuar një takim, me pjesëmarrjen e pothuajse të gjithë anëtarëve të dhomës, duke mundësuar njohjen me projektligjin. Aty kanë dhënë të gjithë mendime, të cilat besoj se duhet të kenë ardhur edhe pranë jush.

Jam dakord me parafolësit në lidhje me shumë pika që u trajtuan këtu. Kundërshtimet e noterëve të Dhomës së Shkodrës janë fokusuar kryesisht në lidhje me nenin 8 dhe nenin 15 të projektligjit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është normale që projektligji paraqet epërsitë e veta në raport me ligjin e mëparshëm. Jemi shumë dakord me çfarë thanë parafolësit, dhe qëllimi është të bëjmë një përmirësim si për sa i përket ruajtjes së përmbajtjes së arkivave. Më bën përshtypje një gjë, që ka noterë që u është hequr licenca, kanë ndërprerë aktivitetin, por faktikisht arkivi i tyre nuk dihet ku ndodhet. Na vijnë shkresa nga organet e prokurorisë, nga gjykata dhe gjendemi në një pozicion të papërshtatshëm, sepse nuk dimë ku t’i adresojmë. Megjithëse janë marrë vendimet përkatëse për ngritjen e një komisioni, siç e parashikon ligji, për t’ia dorëzuar arkivin ndonjë noteri më të vjetër ose atij ë ka kushte më komode për ruajtjen e arkivit. Pra, mendoj se është një çështje që duhet parë.

Në dhomën ku unë jam kryetar, janë tre noterë, arkivi i të cilëve nuk dihet ku ndodhet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Një i Lezhës dhe dy të Shkodrës.

Me çfarë u parashtrua këtu, mund të ketë edhe raste të tjera, po përgjithësisht Dhoma e Noterëve Shkodër ka qenë dakord me projektligjin që është përcjellë për të dhënë mendimet tona.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Radovani!

Nëse i keni me shkrim, mund të na i sillni. Në fakt, që të jemi korrektë, disa nga noterët e Dhomës së Noterisë Shkodër na kanë nisur dokumente. Mund të na i sillni ato të mbledhjes që keni bërë, në mënyrë të përmbledhur, që t’i kemi.

Dhoma e Noterisë Durrës.

**Ermira Agaraj** – Përshëndetje të gjithëve!

Quhem Ermira Agaraj, notere në qytetin e Durrësit, kryetare e Dhomës së Noterisë Durrës.

Pikësëpari desha të shprehja falënderimet e mia për ftesën në këtë tryezë konsultimi në lidhje me projektligjin “Për noterinë”.

Në opinionin tim dhe të kolegëve të mi, konstatoj dhe vlerësoj se ky projektligj sjell ndryshime dhe përmirësime të dobishme, që lidhen me noterinë si institucion, me organizimin e saj të brendshëm, me raportin me të tretët, si dhe me mbarëvajtjen e vetë aktivitetit noterial, duke përfaqësuar kështu të ardhmen europiane të notariatit shqiptar.

Për të mos u zgjatur, që në fillimet e veta drafti i projektligjit na është përcjellë në mënyrë të rregullt nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, për të dhënë sugjerimet e mendimet tona, që kur ishte projekti me amendimet që do t’i bëheshin ligjit në fuqi.

Në këtë moment e shoh shumë të arsyeshme e me vend, që të kujtoj takimin që kemi bërë, të organizuar nga dhoma, me të nderuarën zonjën Hysi, takim në të cilin pjesëmarrja ishte e gjerë. Kanë qenë noterët, personalitete të tjerë, të huaj e vendës. Diskutimet kanë qenë gjithëpërfshirëse nga të pranishmit.

Mbas këtij trajnimi, mendoj se edhe nga Dhoma e Noterisë Durrës ju kanë ardhur opinione në lidhje me materialin që u paraqit aty. Më kanë shprehur opinionet e tyre, duke më thënë se vërtetë parlamenti ka prekur dhe ka pasqyruar për momente të caktuara mendimet e noterëve që kanë ardhur.

Pra, ka qenë një bashkëpunim i frytshëm sa u takon opinioneve dhe eksperiencave që mund të kenë sjellë noterët, që ligjvënësi ka parë të arsyeshme t’i pasqyrojë në ndryshim.

Meqenëse drafti i përcjellë, ky që kemi në dorë nuk është përfundimtari, sepse edhe nga Dhoma e Noterisë, vetë zonja Sadushaj, na është bërë e qartë përmes e-mailit, se është në fazën e shqyrtimit e diskutimit. Ka dispozita ligjore, që ende nuk janë dakordësuar me të gjithë hartuesit e këtij ligji. Ne jemi në momentin e duhur, që të shprehim sugjerimet tona, me qëllim

përmirësimin e këtij ligji, sepse kjo i shërben edhe qëllimit për të cilin jemi këtu. Atëherë, nuk do t'i trajtoj nenet 8 dhe 14, pika 2, pika 4, që është pikërisht ndalimi që i bëhet asistentit dhe i zëvendësnoterit të bashkëshorti dhe fëmijët, sepse është ezauruar.

Do të filloj me nenin 30: “Rrethi gjyqësor dhe zyra e noterit”. Fjalja e fundit e këtij neni, që thotë: “Kryerja nga noteri i akteve noteriale jashtë territorit të përcaktuar...”

**Vasilika Hysi** – Neve kemi afatet e hetimit këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos e keni me draftin e vjetër? Ka mundësi të jetë me draftin e vjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermira Agaraj** – Atëherë në rregull!

Rrethi gjyqësor dhe zyra e noterit. Po e bëjmë kështu. Është fjala për përcaktimin e kompetencës tokësore të noterit, që u tha, por që desha ta ritheksoja edhe si përcjellje mendimesh të anëtarëve të dhomës sime, për ta përcaktuar qartë.

Vërejtja është kjo: fjalia e fundit e këtij neni bie në kundërshtim me rregullaritetin, që vetë ky nen synon të sjellë. Pra, ky përcakton kompetencën tokësore të noterit. Ndërkohë sugjerojmë të hiqet fjalia e fundit, të bëhet një shtesë, ku të përcaktohet qartë dhe pa ekuivoke, që noteri nuk mund të kryejë akte ose veprime noteriale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të jetë e përcaktuar, për të mos lënë ekuivoke. Ky nen le të riformulohet për të mos lënë ekuivoke të kësaj natyre.

“Shkeljet disiplinore dhe masat kundër noterit.”

Është ajo që u tha. Edhe kjo përcillet nga dhoma e noterisë. Nuk ia vlen që ta konsumojmë.

Detyrat e noterit. Pika “d” e këtij neni ka paqartësi në lidhje me çfarë do të informojë noteri degën dhe dhomën. Kam përshtypjen se i krijohet një burokraci e panevojshme, pasi noteri informon palët për ata që janë pjesëmarrës në akt, gjë që është një detyrë funksionale e tij.

Pika “ç” e nenit 67 të riformulohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi, ju lutem!

Ka një problem. Zonja Agaraj, unë e shoh se ju i keni që të gjitha të detajuara me shkrim, në të cilat është marrë edhe mendimi i dhomës.

**Ermira Agaraj** – Po. Mund t’jua sjell.

**Ulsi Manja** – Ashtu siç i keni listuat aty, do të ishte efektive që ne t’i kemi të gjitha me shkrim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kuptoni tani se çfarë po më thoni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ka një linjë logjike ligji. Në qoftë se thuhet: “afatet e hetimit”, ajo i ka të listuara afatet e hetimit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, gjejeni dispozitën, nenin konkret të ligji i ri, dhe i reflektojme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermira Agaraj** – E bëj unë përshtatjen...

**Ulsi Manja** – Zonja Agaraj, të lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetëm dy gjëra kam.

**Ulsi Manja** – Do të thuash pesë gjëra, por kjo nuk përbën problem për materialin që ju keni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermira Agaraj** – Jo, jo, pa merak fare!

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdoni!

**Ermira Agaraj** – “Nënshkrimi i aktit nga palët”. Mund ta gjeni si definicion neni. Një konstatim: nuk e di nëse është gabim apo çfarë tjetër, por nuk parashikohet njohja personale, që noteri mund të ketë me personin që i paraqitet në zyrë. Domethënë, është harruar apo është ndaluar?

**Ulsi Manja** – E kemi, e kemi. E kemi atë dispozitë.

**Ermira Agaraj** – Diçka tjetër. Po të “Nënshkrimi i aktit noterial nga palët.”. Person - pala që nuk di të shkruajë, thotë ligji, autorizon një person të besuar, që ai të nënshkruajë për të. Kjo është përmbajtja e nenit.

Mendimi im dhe i kolegëve të mi, i përcjellë nëpërmjet meje, është që në nen të shtohet: “Person - pala që nuk di të shkruajë, shpreh vullnetin nëpërmjet vendosjes së gishtit tregues të dorës së djathtë.”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Janë gjëra teknike këto, kryesisht. Të dyja duart, do t’i përcaktojmë, të dhjetë gishtat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo edhe për faktin se pala i shton vërtetësinë juridike aktit. Është një element sigurie, që rrit vlefshmërinë e aktit, por në fund të fundit është edhe një provë, në rastin e ndonjë kontestimi të këtij akti. Mbron noterin, mbron palën, mbron të gjitha interesat. Domethënë, këtë do ta shikoja si një moment jo pak të rëndësishëm në të drejtat që ka noteri në përpilimin e një akti.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Lidhur me arkivin e noterisë, në nenin 71 jepen rregullime për arkivin e noterisë në rast mbylljeje të përkohshme ose të përhershme. Sugjerimi im është që të nxirret një udhëzim ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë për përcaktimin e rregullave për asgjësimin e akteve që ne mbartim sot.

Unë jam kryetare e dhomës prej shumë vjetësh dhe has një problem shumë të madh në lidhje me asgjësimin e akteve që e kanë plotësuar afatin e tyre ligjor. Këtu nuk e kam fjalën për ato akte ligjore, që jemi të detyruar t'i mbajmë në ruajtje të përhershme, të cilat bëjnë pjesë në pasurinë që trashëgohet në momentin që një noter lë licencën, del në pension ose ikën e të tjerë. Domethënë, për asgjësimin e akteve, që me ligjin tonë e kanë mbaruar afatin e ruajtjes së tyre. Për shembull, kemi deklarata noteriale të bëra në vitin 2002 dhe sot fëmija është bërë madhor, është bërë prind, por ne vazhdojmë t'i mbajmë në zyra këto akte, nuk i kemi asgjësuar, sepse nuk kemi...

**Ulsi Manja** - Ju lutem, a mund të bëj një pyetje, meqenëse jemi tek arkivi. Unë merakun më të madh e kam tek arkivi, sepse arkivi është pasuri kombëtare dhe duhet të trajtohet si pasuri kombëtare. Pra, edhe një copë letër e përpiluar në zyrën e një noteri ka vlerë dhe nuk ka asgjë të keqe t'i nënshtrohet ruajtjes, sipas ligjit për arkivat. Pas nesh do të vijnë breza të tjerë, gjenerata të tjera, të cilat do të kenë nevojë të shikojnë si ka punuar Ermira Agaraj, si ka punuar Mimoza Sadushi, si ka punuar Ulsi Manja e të tjerë me radhë. A keni menduar ndonjëherë se si mund të dixhitalizohen arkivat tuaja, të cilat i keni në ruajtje dhe janë pasuria juaj, njëkohësisht edhe e shtetit dhe e publikut? Unë e di se ju do të dilni te shpenzimet, por a ka ndonjë mundësi dhe a është diskutuar ndonjëherë midis jush se si mund të dixhitalizohet arkivi juaj, pra ashtu siç po bëhet dixhitalizimi i Arkivit të Shtetit, ashtu siç ne kemi dixhitalizuar të gjithë arkivin e Kuvendit? Madje, ne kemi dixhitalizuar të gjitha diskutimet në parlament, që nga viti 1920, në momentin kur është futur teknologjia dhe i kemi të gjitha dokumentet të dixhitalizuara. Pra, juve ju duhet një fjalim i Luigj Gurakuqit në parlament të vitit 1928, unë ju garantoj se do ta gjeni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** - Në rregull, ju kërkoi ndjesë!

Domethënë, nëse kërkoni një fjalim të tij apo të Fan Nolit do ta gjeni falë një pune dhe një projekti shumë rezultativ, që më në fund digjitalizua gjithçka kemi në Kuvend. A është menduar ky variant në shërbimin e noterisë? A mund të më japësh një përgjigje dhe më pas vazhdojmë me të tjerat?

**Ermira Agaraj** - Unë mendoj se do të ishte shumë pozitive që ky variant të marrë zhvillimin e tij, por do të mbetem te ndarja. Pra, çfarë duhet të ruajmë dhe cilat akte do të bëhen asete të pasurisë shtetërore, sepse janë shumë akte që, sipas meje, nuk kanë vlerë më për t'u bërë asete të pasurisë shtetërore.

Sipas udhëzimit ato le të kalojnë, por ndoshta unë nuk e kuptova mirë pyetjen.

**Vasilika Hysi** – Ju lutem, zonja Mira, shtypeni mikrofonin se nuk po regjistroheni!

**Ermira Agaraj** – Atëherë, e kam fjalën për aktet që ne kemi në zyrat tona, të cilave, në bazë të udhëzimit përkatës, nuk u është përcaktuar afati i ruajtjes. Pra, ka akte që afatin e ruajtjes e kanë të përcaktuar 1 vit ose 5 vjet, por kanë kaluar 15 vjet.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ermira Agaraj** - Pra, kjo ishte ideja, a kam apo jo të drejtë ta asgjësoj direkt apo do të ndjek mënyrën e asgjësimit?

**Ulsi Manja** - Dakord!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë jam për variantin që pas mbarimit të afatit të përdorshmërisë, sigurisht ai akt të bëhet pjesë e Arkivit të Shtetit. Pa diskutim, nëse një dokument do të ruhet në arkivin e një noteri 15 apo 20 vjet, pas kalimit të këtyre viteve, ai do të bëhet pjesë e fondit arkivor, sepse e ka menduar shteti edhe këtë pjesë. Kështu që gjithçka që keni në zyrat tuaja është pasuri kombëtare dhe nuk diskutohet kjo pjesë. Problemi është që të zgjidhim situatën që kemi, sepse është shumë e rëndësishme si t'i administrojmë këto akte dhe një nga mundësitë është dixhitalizimi i arkivave. Thelbi i diskutimit është dixhitalizimi, i cili do të na eliminojë edhe shumë gjëra të tjera.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Ju lutem, le ta mbarojë fjalën zonja Ermira, që më pas t'ua japim fjalën përfaqësuesve të Dhomës së Noterisë Tiranë!

**Ermira Agaraj** - Dua të theksoj edhe një element teknik. Në bazë të udhëzimit, është e detyruar të ruhet kopja e dokumentit që ne njësojmë me origjinalin dhe pas një viti ky dokument me ligj nuk duhet ruajtur më. Çfarë do të bëhet më pas me këtë dokument?

**Ulsi Manja** - Do ta zgjidhim edhe këtë gjë, sepse e kemi shënuar.

**Ermira Agaraj** – Kjo është bërë me një udhëzim të Ministrisë së Drejtësisë.

**Vasilika Hysi** – A keni ndonjë gjë tjetër?

**Ermira Agaraj** – Tjetër gjë kemi lidhur me llogarinë rrjedhëse të noterit.

**Vasilika Hysi** - Çfarë shqetësimi keni lidhur me llogarinë rrjedhëse të noterit, të cilën e keni te neni 72.

**Ermira Agaraj** – Kjo pjesë është ezauruar.

Atëherë, lidhur me procedurën e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë kur kemi më shumë se një testament, definicioni është ky: “Procedura e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë kur kemi më shumë se një testament” dhe në pikën 5 bëhet përjashtimi. Unë sugjeroj, ky është mendimi im, që noteri, i cili ka testamentin e dytë, duhet të çelë dhe të lëshojë dëshminë e trashëgimisë, sepse është ai që do të shqyrtojë dhe deklarojë pavlefshmërinë e testamentit të dytë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ermira Agaraj** – Është te neni 131, pika 5.

**Vasilika Hysi** – Pra, ju jeni për pikën 5, në rast se janë hartuar dy teste, dëshmia të deklarohej e pavlefshme.

**Ermira Agaraj** – Po.

Pra, unë mendoj të formulohet kështu: “Noteri i testamentit të dytë, pasi ka administruar procesverbalin e çeljes së testamentit të parë nga noteri i parë, vijon procedurën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë në të cilën shpall pavlefshmërinë”.

**Vasilika Hysi** – A e keni gati formulimin?

**Ermira Agaraj** – Po.

**Ulsi Manja** - Zonja Ermira, ju lutem, për efektivitet kohe mendoj se gjithçka që keni duhet të na e sillni edhe në rrugë elektronike.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu edhe me shkrim.

**Ulsi Manja** – Patjetër, sepse me shkrim ajo do të na i dorëzojë sot, por duhet të na i dërgojë edhe në rrugë elektronike.

**Ermira Agaraj** - Patjetër!

**Ulsi Manja** – Këto materiale do të jenë me vlerë për ne, sepse mund të punojmë mbi to për efekt kohe.

**Ermira Agaraj** – Unë do ta mbyll këtë pjesë të diskutimit, sepse detajet e tjera ju i keni të shkruara këtu.

Gjithashtu, unë dua të ndaj me ju mendimin tim personal në lidhje me implementimin e platformës “NISA”. Unë këtë nismë e shikoj shumë të rëndësishme. Aktualisht sot, nëse do

t'i marrim të shpërndara, kur u fut portali e-albania neve na e lehtësoi shumë punën në zyrë, sepse kur qytetari vinte të bënte një deklaratë më parë i duhej të shkonte në zyrën e gjendjes civile që të merrte certifikatën familjare. Në këtë rast ky dokument del në këtë faqe portali dhe ne i kryejmë të gjithë shërbimin qytetarit. Gjithashtu, ne mund të futemi *online* nëse na duhet një vërtetim për gjendjen juridike të mjetit, për gjrobat, për detyrimet e tjera ndaj shtetit. Ky është një favor dhe një privilegj në shërbim të qytetarit, ndërsa "NISA"-n e shikoj si një platformë, e cila përfundimisht, në konceptin tim, nëse do të funksionojë siç duhet, duket si një shkop magjik. Pra, nëse do të bëhet kjo, i bie që unë nga zyra të kem në dorë AKSHI-n, i cili do të më japë informacionin dhe dokumentacionin që do t'i kërkoj që unë t'i shërbej më pas qytetarit. Ku shkoj unë me këtë logjikë? Logjika ime shkon që qytetari do të shmangë kontaktin me nëpunësit e shtetit, do të shmangë burokracinë, korrupsionin, njohjet dhe preferencat.

Ne që i kemi fëmijët jashtë shtetit e shikojmë se ata të gjitha shërbimet i marrin nëpërmjet sistemit online. Personalisht e ndaj këtë mendim (nuk po u referohem shifrave të tilla që po dëgjoj këtu, sepse nuk është pjesë e diskutimit këtu, jo kaq euro apo aq euro), sepse përveç interesit tim personal si notere, që mbart në bazë të ligjit të gjithë personalitetin e duhur në ushtrim të funksionit që kam për t'i shërbyer qytetarit, ndërkohë edhe qytetari merr një shërbim cilësor, të shpejtë dhe të plotë.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zonja Agaraj!

**Vasilika Hysi** - A mund të bëj një pyetje?

**Ulsi Manja** - Të mbarojmë me zotin Treska nga Dhoma e Noterisë Tiranë dhe më pas vazhdojmë me pyetjet.

**Artan Treska** - Atëherë, do ta filloja me pjesën e trashëgimisë, sepse përfaqësuesja e EURALIUS-it trajtoi këtu sistemin francez, që quhet i vjetruar. Praktikisht kam nxjerrë një përmbledhje, që e drejta e trashëgimisë në Francë daton që në vitin 1816, ku vetë noteri propozon emrin e zëvendësuesit të tij te ministri i Drejtësisë, i cili në të shumtën e rasteve vendos emrin. Kjo tregon se asnjë nuk e ndalon noterin të propozojë fëmijën e tij si zëvendësues.

Në Këshillin Kushtetues të Francës, që është i barazvlefshëm me Gjykatën Kushtetuese në Shqipëri (sepse u tha që është në sistem i vjetër dhe ata po e heqin), njëherë u dërgua një çështje nga një i diplomuar, i cili nuk kishte mundur të ishte i zgjedhuri i noterëve ku kishte punuar dhe e konsideronte të padrejtë. Gjykata Kushtetuese franceze, me vendimin e saj të datës 21.11.2014, vendosi: "Zyrat noteriale janë biznese private si të tjerat dhe asgjë nuk i ndalon që të vendosin mbi të ardhmen e tyre. Ata kryejnë një mision publik kur bëjnë një kontratë ose kur ushtrojnë të drejtën e tyre publike, por nuk janë funksionarë publikë, pasi nuk



paguhen nga shteti, por nga klientët e tyre, të cilët janë të lirë të zgjedhin noterin e tyre dhe noterët janë të vetmit përgjegjës për mirëfunksionimin e zyrës së tyre. Noterët ushtrojnë profesion të lirë të rregulluar me ligje të veçanta për funksionimin dhe për tarifën. Rrjedhimisht e drejta e trashëgimisë nuk është antikushtetuese dhe nuk është në kundërshtim me deklaratën e të drejtave të njeriut të vitit 1789.” Kaq kisha për pjesën e trashëgimisë. Dua të t'i jap zonjës Hysi një përgjigje për RNSH-në.

RNSH-ja ka të gjithë sigurinë e krijuar nga Ministria e Drejtësisë për aktet noteriale që ne kemi aty dhe mundësia që ne kemi për të manipuluar aktin është zero. Çfarë ndodh? Në qoftë se ne nuk marrim akses nga Ministria e Drejtësisë për të hapur një numër gabim, një datë gabim apo çfarëdolloj veprimi gabim, pra gjëra që janë të gatshme dhe që mund ta zgjidhen, për shembull, në vend që të zgjedhësh një prokuror, ke zgjedhur një kontratë shitjeje, ne nuk kemi asnjë mundësi që të hyjmë dhe të manipulojmë sistemin, sepse nëse klikon në sistem "arkivo" sistemi më pas mbyllet. Ndërkohë, që RNSH-ja ka të përfshirë edhe regjistrin e testamentëve, ka edhe regjistrin e dëshmimeve të trashëgimisë dhe neve shteti sot na i ofron pa lekë.

Lidhur me arkivat noteriale, është një nga problemet që unë realisht do të doja që ky projektligj ta kishte trajtuar me më shumë kujdes. Pse? Ka vite që midis Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Noterëve dhe Dhomës së Noterëve Tiranë, që unë përfaqësoj, luhet një lloj pingpongu. Unë pasoj te ministria, kurse ministria pason te Dhoma Kombëtare e Noterëve.

**Vasilika Hysi** – Zoti Artan, po ju të drejtohem shoqërisht, sepse ne njihemi shumë mirë. Ne arkivin e kemi me merak dhe kryetari e tha disa herë, ndaj, ju lutem, bëni një sugjerim konkret, kurse politikën ma lini mua ta bëj.

**Artan Treska** – Jo, nuk po bëj politikë, profesoreshë!

Po ju drejtohem me profesoreshë, sepse ju keni qenë pedagogia ime.

**Vasilika Hysi** - Unë kam interes që ta riformulosh si problem.

**Artan Treska** - Problemi qëndron këtu, që arkiva noteriale duhet të mblidhet urgjent.

**Vasilika Hysi** - Shumë mirë, se edhe unë këtë doja të dija.

**Artan Treska** - Sot për dhënien e një dokumentacioni, që është në arkivin noterial, qytetari paguan 2 mijë lekë të rinj dhe nuk janë pak. Në këto kushte, kur ky shërbim paguhet, unë mendoj se arkivi noterial duhet të mblidhet nga Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe këtë shërbim ta japë kjo dhomë. Pra, kur Dhoma Kombëtare e Noterëve do t'i japë një X apo Y qytetarit një kopje të dokumentacionit që ndodhet në arkiv, le t'i vendosë edhe këtë tarifë.

Së dyti, cili është problemi që janë zhdukur arkivat? Edhe kryetari i Dhomës së Noterëve Shkodër kishte të njëjtin problem, por edhe unë e kam këtë problem me shumë arkiva. Është e turpshme kur një qytetar më pyet dhe unë nuk e di se ku është arkiva e X apo Y noteri. Pse ka ndodhur kjo? Kjo ka ndodhur për faktin e thjeshtë se arkiva noteriale mblidhet nga Ministria e Drejtësisë në momentin që noteri ka dalë në pension. Më falni për shprehjen, por kur noterit del në pension nuk i bëhet vonë as për ministrinë dhe për asgjë tjetër.

Ministria sot ka të gjitha mjetet e duhura, me ligjin aktual, t'ia marrë arkivin noterin edhe me anë të zyrës së përmbarimit. Unë propozoj që arkivat noteriale t'u merren noterëve kur ata janë ende në punë. Unë jam i gatshëm që sot ta jap arkivin tim. Ky është propozimi im.

**Vasilika Hysi** - Brenda çfarë afati?

**Artan Treska** - Brenda një afati 10-vjeçar.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Zoti Artan, na e thoni edhe njëherë propozimin tuaj!

**Artan Treska** - Atëherë, propozimi im është: nëse aktit i ka kaluar afati 10-vjeçar, nga dita që është përpiluar, noteri të detyrohet ta dorëzojë atë në arkivin e përgjithshëm të noterëve të Shqipërisë. Kjo për arsyen e thjeshtë, sepse ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** - Neve na interesojnë propozimet konkrete dhe ndërmjet këtyre propozimeve do të zgjedhim më racionalen.

Mund të vazhdoni, zoti Treska.

**Artan Treska** - Ky është propozimi im, sepse unë e kam vjelë tarifën time për atë akt. Unë nuk mund të pretendoj që qytetari të më paguajë me 2 mijë lekë sa herë që ai do të më kërkojë të njëjtin akt. Ndërkohë, këtë gjë mund ta marrë përsipër shteti dhe ta menaxhojë shteti dhe ky problem, që sot është madhor për arkivat, do të vijë duke u shuar.

Unë kam edhe një propozim tjetër: kur noteri të jetë në 5 vjetët e fundit të ushtrimit të veprimtarisë së tij, ai duhet ta dorëzojë arkivin e tij çdo vit. Pra, vetëm në këtë mënyrë ju do të arrini t'i mblidhni arkivat, por ky është propozimi im personal.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Genta, ti mund ta diskutosh me mua, por ky është propozimi im personal.

**Ulsi Manja** – Nuk e kuptoj se çfarë problemi ka që alarmoheni. Ky është një propozim. Nëse na duket racional kur të ngremë kartonin, do ta marrim në konsideratë.

**Artan Treska** – Ky është propozimi im për arkivat. Ligji ka një mangësi të theksuar në lidhje me Dhomat Rajonale. Praktikisht ka vetëm një dispozitë që parashikon kompetenca, por se çfarë strukture do të kenë, si do të zgjidhen dhe si do të funksionojnë nuk na jepet asnjë

agrument. Gjithashtu u është hequr edhe pavarësia financiare dhe mbi të gjitha nuk parashikon se çfarë organesh ka. Kjo ka ndodhur në nxitim e sipër, apo janë harruar, këto nuk e di, por kjo do t'i shkatërrojë.

**Vasilika Hysi** – Çfarë sugjeroni konkretisht?

**Artan Treska** – Unë sugjeroj minimalisht të ruhet struktura dhe të vendoset titulli i kryetarit. Këtu asnjëri të mos ketë merak, sepse unë nuk gëzoj mbështetjen e duhur.

Për digjitalizimin e arkivave, meqenëse zoti Manja bëri një pyetje, praktikisht arkivin tim e kam totalisht të digjitalizuar dhe i kam të skanuar të gjitha nga e para tek e fundit. Nëse doni, mund ta tregoj edhe se si e kam skanuar.

**Vasilika Hysi** – Jo na intereson.

**Artan Treska** – Fëmijët e mi që në moshën 10-vjeçare, kur vinin nga shkolla, i kam vënë që të skanojnë arkivin tim. Pra çdo ditë nga data 1 prill e vitit 2001 dhe deri më sot unë i kam digjitalizuar dhe, kur më vjen qytetari, nuk e hap dollapin, por i bie emrit dhe më nxjerr aktin që ai kërkon dhe kur e do. Kjo është një punë që mund të bëhet nga ne me një kosto minimale.

**Vasilika Hysi**– Sa të ka kushtuar dhe sa kohë të ka marrë?

**Ulsi Manja** – Na trego si kohë.

**Artan Treska** – Si kohë, nga viti 2011 deri në mars të vitit 2013, pra rreth 2 vjet e gjysmë. Kjo ka zgjatur, sepse nuk është se kishim ndonjë përkushtim për të punuar çdo ditë, kur kam skanuar unë mund të kem bërë edhe 100 akte në ditë, sepse e kam filluar vetë këtë punë.

**Vasilika Hysi** – Po financiarisht sa të ka shkuar?

**Artan Treska** – Fëmijët e mi ishin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo punë thjesht një skaner të mirë do.

**Ulsi Manja** – Ju lutem, kjo është një eksperiencë shumë e mirë, shpresoj të jetë edhe te noterë të tjerë.

**Artan Treska** – Po ka edhe noterë të tjerë.

**Ulsi Manja** – Këtë duhej ta kishte bërë me kohë Dhoma Kombëtare.

Mund të vazhdoni, zoti Treska.

**Artan Treska** – Tri nga pikat që anëtarët e dhomës time i kanë nxjerrë si më të nxehtat e këtij projektligji janë: e para është trashëgimia, të cilën e trajtuam.

Zëvendësnoteri është i parregulluar për konceptin tonë. Pra, është rrezik potencial që ta çorientojë veprimtarinë noteriale, nëse do të futet ashtu siç është e parashikuar në ligj.

Anëtarët e Dhomës së Noterëve në Tiranë janë kundër sistemit digjital dhe nuk e duan.  
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata kërkojnë në mënyrë kategorike që të hiqen të gjithë përcaktimet ligjore që janë futur në projektligj për “NISA”. Përse? Sepse, së pari, ata duan që të pyeten dhe, nëse ne duam të bëjmë një sistem për noterët, jemi të gjithë gati. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Noterëve e voton 50 plus një noter, atëherë ne jemi dakord që edhe ne të shkojmë pas rrymës. Por ama noterët i shqetësojnë përcaktimet në ligj të krijimit të sistemeve digjitale. Ne mund të bëjmë kongrese dhe asamble, por nëse kjo gjë do të futet në ligj, kjo punë saldohet dhe merr fund.

Në përfundim, ne kërkojmë të ripunohet projektligji, nëse këtë nuk e keni si option, atëherë do të kërkonim që ne të bëhemi pjesë e grupeve të punës që të sistemohet e gjithë kjo. Materialin e përpunuar me mendime të të gjithë anëtarëve të Dhomës së Noterëve në Tiranë e kam dhe mund t’jua lë, gjithashtu mund t’jua sjell edhe në formë digjitale.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Besoj se në këtë takim noterët dhe ne kemi interes që realisht të kemi një projektligj të mirë, sepse gjithsej janë 470 noterë. Ligji do të votohet në Kuvend dhe mbi interesat individuale do të ketë një gjykim dhe një vendimmarrje nga një panel ekspertësh që janë deputetët e Komisionit të Ligjeve, nga EURALUS-i, nga Ministria e Drejtësisë, nga ju që jeni sot dhe nga një nivel tjetër që janë kolegët tanë që do ta manifestojnë këtë gjë me votë. Ne kemi interes që të bëjmë një ligj të mirë, këtë ia kam thënë edhe koleges sime Justi, sepse unë vijë nga sistemi i drejtësisë, ashtu siç vijnë shumica e kolegëve të mi.

Këtu do të marrë fund praktika që një shtëpi të shitet 20 herë në noterë të ndryshëm. Këtu do të marrë fund praktika të ndërhyhet në arkiva dhe në regjistrat noterialë, duke e lënë në ndërgjegje të noterit. Pra, duhet të marrin fund disa praktika që janë shqetësime për qytetarët, sepse, kur unë të mos jem më deputet dhe ju të mos jeni më noterë, pra të jemi qytetarë të zakonshëm, do të duhet që shërbimin ta marrim njëlloj të gjithë.

Përse kujtohemi ne deputetët për ligjin vetëm kur na vihet gjoba në semaforë, të cilin e kemi votuar vetë? Pra, kujtohemi dhe na dhemb kurrizi kur e marrim gjobën vetë, por, në fund të fundit, ligji duhet të jetë i barabartë për të gjithë. Ky është shqetësimi që ne kemi me arkivin, me aktet noteriale dhe me ca rregulla e parime që duhet t’i përcaktojmë në ligj. Nuk do të bëjmë ndonjë gjë që nuk e ka bota dhe as Europa, do të bëjmë atë gjë që e ka Europa ku duam të shkojmë. Nuk do të marrim modelin dhe ligjin e noterisë të vendeve të botës së tretë.

Këtu kemi zonjën e nderuar, e cila ka këtu pesë orë këtu dhe është e palodhur në këtë drejtim. Agnesi është partnerja jonë kryesore prej katër vjetësh, kjo sepse ne duam të shkojmë në Europë.

Pra, të bëhen propozimet konkrete, mund të mos jemi dakord për të gjitha, por do të kemi mundësi t'i marrim në konsideratë me gjithë durimin e duhur. Mos harroni, vetëm për noterinë ne kemi organizuar dy herë në të njëjtën tryezë të njëjtin format brenda tri vjetësh. Kjo nuk na ka ndodhur me ndonjë shërbim tjetër. Mbas jush kemi përmbarimin privat dhe shpresojmë që të mos jenë kështu si ju. Ata kanë një problem tjetër, janë të paktë në numër, gjithsej janë 280 licenca të lëshuara dhe e ushtrojnë profesionin vetëm 130, pra nuk ka kërkesa për atë profesion.

Kush e do fjalën? Fjalën e ka zonja Sadushi.

**Mimoza Sadushi** – Dua të shprehem për arkivat, ndoshta do të ishte mirë që të përcaktohet në ligj që të gjithë noterët t'i digjitalizonin arkivat dhe më pas të kalojë arkiva sipas afateve, si ta mendoni, ndoshta tek arkivi i shtetit ose ku e mendoni ju. Këtë e kërkoj për faktin që qytetari për një akt që ka bërë te Sonila, duhet të shkojë ta marrë te Sonila për ta certifikuar me firmën elektronike dhe jo të vijë te Arkiva e Shtetit në Tiranë për ta kërkuar. Pra do të ishte shumë mirë që të gjithë arkivat të jenë të digjitalizuar dhe qytetari të shkojë te noteri që ka bërë aktin dhe jo nga Vlora të shkojë në Tiranë për ta marrë aktin në Arkivin e Shtetit.

E dyta, harrova të përmend edhe një fakt për vendet e treta apo të dytat ku ne bëjmë pjesë së bashku me Kosovën, Maqedoninë, Serbinë dhe Bosnje – Hecegovinën, të gjithë jemi në një standard me bërjen e sistemeve. Çdo vend po bën sistemin nën kujdesin e projektit GIZ, këtë nuk duhet ta harrojmë. Kemi filluar të parët dhe jemi të fundit. Të gjithë po e bëjnë sistemin, prandaj ne nuk mund të dalim jashtë këtij raporti, megjithatë përsëri jemi ne ata që e vendosim nëse duam të dalim dhe kjo nuk ka asnjë vështirësi. Gjërat nuk po bëhen, sepse do t'i bëjë Moza, gjërat duhet të bëhen ashtu siç duhet. Kaq kisha për të thënë.

**Ulsi Manja** – Vasil, të lutem shumë shkurt për këtë dhe të lutem të mos flasim më për platformën.

**Vasil Martini** – Nuk do të flas për platformën. Te neni 134 duhet të shtohet pika 3, “Kopje të dëshmisë së trashëgimisë, që janë lëshuar për personat e interesuar”, sepse kemi një kontradiktë në ligj. Ne kemi për detyrë t'ua japim palëve që kanë marrë pjesë në akt ose trashëgimtarëve, por, kur nuk është lëshuar kërkesa e trashëgimisë, kërkesën mund ta bëjë edhe një përmbarues dhe një institucion që është në një proces gjyqësor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kopjet e dëshmisë së trashëgimisë mund t'u lëshohen edhe palëve që kanë interes të ligjshëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Siç kanë interes të ligjshëm për të kërkuar lëshimin e dëshmisë, mund të kërkojnë edhe kopjen.

**Vasilika Hysi** – Po të dhënat personale?

**Vasil Martini** – Atëherë, dëshmia e trashëgimisë nga momenti që lëshohet është publike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dëshmia e trashëgimisë nuk ka të bëjë me të dhënat personale, sepse është dokument që do ta paraqesësh edhe në zyra të tjera. Prandaj për një proces civil...

**Vasilika Hysi** – A mund ta marrë pala kundërshtare?

**Vasil Martini** – Po.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është debati, sepse shumë gjyqe shtyhen për këtë shkak, sepse pala tjetër nuk e jep dhe gjykata i jep urdhër që ta marrë, por në këtë rast gjykata nuk është e nevojshme të ndërhyjë.

**Vasilika Hysi** – Dua të them një gjë për këtë. Ne sapo ndryshuam ligjin e gjendjes civile dhe ju keni një problem shumë të madh me zyrat e gjendjes civile kur bëni kërkesë për të marrë informacion. Propozimin tuaj, të cilin e kam ngritur dhe e kam diskutuar me zotin Doracaj disa herë, meqenëse ju gjobisni zyrat, i çoni nëpër gjyqe dhe bllokoni llogaritë, duhet të reflektohet edhe te ligji i gjendjes civile, në mos gaboj është neni 3, paragrafi 3. Pra shumë gjëra që po propozoni mund të afektojnë edhe ligje të tjera, prandaj do t'ju lutesha që, kur të bëni propozime, të bëni edhe një koment poshtë, që pengesa është te ky ligj, që edhe ne të bëjmë rekomandim edhe për amendimin e një ligji. Ne kemi shumë probleme me zyrat e gjendjes civile, sepse ligji nuk u lejon nëpunësve të gjendjes civile të japin informacion nëse nuk ka prokurë. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka penguar dhe i ka penalizuar. Ju bëni presion si Dhomë e Noterisë, sepse ua rregullon ligji juaj dhe i avokatëve, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale thotë: vetëm kur ke prokurën nga personi mund të autorizosh dhe të japësh të dhëna personale, pra jemi në një konflikt ligjesh të cilat ligjvënësi duhet t'i adresojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E keni dhënë, por Komisioneri ka ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E kuptoj zonja Hoxha, ju e keni bërë këtë gjë, por ky problem është ngritur këtu në komision kur bëmë ndryshimet në ligj. Pra, e gjithë çështja që diskutohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është që ata nuk ju përgjigjen dot, sepse në ligj thuhet se të dhënat jepen vetëm nëse personi ka autorizuar me prokurë të posaçme. Unë pajtohem që në

praktikë që pala që ka zaptuar një pronë nuk ka interes të japë dëshminë e trashëgimisë, sepse do të marrë qiranë që e ka 1 mijë euro në muaj dhe do ta shtyjë gjyqin sa më shumë. Në këtë kuadër, zyra e gjendjes civile, jo në të gjitha rastet, sepse Vlora i jep, ndërsa Tirana ka probleme, thotë: le ta kërkojë gjykata. Për ta bërë më fleksibël dhe me këtë duhet të flasim edhe me Komisionerin, sepse ai ka thënë se është shkelje të të dhënave personale dhe me direktivën e re të Bashkimit Europian që të fillojmë ta implementojmë. Të dhënat personale nuk mund t'ia japësh as motrës dhe as vëllait dhe jo më palës kundërshtare, prandaj do të sugjeroja që këtë rekomandim që bëni ta shohim në përputhje me ligjet e tjera. Kryetar, këtë ne duhet ta shikojmë, sepse ky ligj lidhet me ligjin e arkivave, por do ta shohim edhe në raport me Kodin Civil. Unë kam ca pyetje për Kodin Civil, sa të mbaroni ju.

**Vasil Martini** – Dua të bëj një shtesë të kjo që the, noteri është konservues i të dhënave personale të të gjithë shtetasve. Në funksion të noterit është një database e të dhënave personale të të gjithë qytetarëve që kanë marrë një shërbim në zyrë. Nuk mund të barazohet cilësia e noterit me asnjë nëpunës tjetër civil për sa i përket konservimit të të dhënave personale. Në ligjin për ruajtjen e të dhënave personale, noteri duhet të ketë një përshkrim të veçantë, gjykoj unë, sepse një qytetar që do të marrë një shërbim, do ta sjellë certifikatën. Pengesa që i bëhet një personi për të ushtruar një detyrë është për të parandaluar një pasojë, por në rastin konkret noteri është ai që ushtron të drejtën, ai që ka të gjitha të dhënat dhe ka akses në të gjitha të dhënat personale për të arritur, përpiluar dhe për të lëshuar një akt korrekt. Prandaj në këtë pikë në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” noteri duhet të ketë një riformulim tjetër për sa i përket aksesit të të dhënave personale, ashtu si do të ketë edhe përgjegjësi penale në rast abuzimit. Në këtë pikë dhe kjo është pjesë që të shikohet për barazi veprimesh. Të kthehemi te neni i arkivës.

**Ulsi Manja** – Dy fjalë për arkivin, sepse jemi jashtë çdo lloj limiti kohe.

**Vasil Martini** – Nisur nga përvoja personale, unë kam 10 vjet që e kam të gjithë arkivin prej 24 vitesh të digjitalizuar dhe nuk e përdor arkivin fizik. Problemi i arkivës fizike fillon në vitin 2013 e në vazhdim që kur ka filluar NRSH-ja, sepse me një implementim të gabuar nga ana e ministrit të Drejtësisë në atë kohë është thënë që të arkivohet vetëm akti dhe jo dokumentet bashkëlidhur. Kjo është një pjesë tjetër që duhet zgjidhur dhe ne si Dhomë kemi një opinion tjetër për këtë pjesë.

Në praktikë ne hasemi me këtë veprim, 10 vjetët e para akti do të rrijë në zyrën e noterit, sepse është afati i parashkrimit dhe për çdo gjë përgjigjesh penalisht, mbas 10 vjetësh në bazë të udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë është e mundshme të lirohet arkiva e noterit, duke u ekzekutuar pjesa e akteve që nuk ruhen. Nga përvoja të gjithë e dimë që në 10 vjetët e

para kërkohen kopje, mbas 10 vjetëve bie fluksi, mbi 20 vjet kemi një fluks shumë të vogël me një ose dy kërkesa në vit. Këtë do e thosha edhe më përpara, por doja të dëgjoja mendimin e kolegëve në raport me digjitalizimin e arkivit, sepse është një punë shumë voluminoze, pra arkiva duhet të digjitalizohet, por mbas 15, 20 apo 25 vjetëve, cili do të jetë kufiri ky arkiv fizikisht nuk do të ekzistojë më. Për efekte të gjykimeve civile akti mund të kërkohet mbas 10, 15 apo 20 vjetësh. Pra në rastin e një gjykimi civil noteri e ka në kompjuter, e printon dhe e certifikon elektronikisht ashtu siç duhet, sepse digjitalizimi presupozon në mënyrë absolute edhe certifikimin elektronik. Duke e bërë arkivin të certifikuar elektronikisht, mbajtja në zyrë për efekte ligjore 10 vjet, e thashë edhe një herë, nuk është efekti i parashkrimit dhe duhet mbajtur në zyrë, ndoshta 15 vjet, ndoshta 20 vjet...

Pastaj, grumbullimi në Ministrinë e Drejtësisë apo në Dhomën Kombëtare... Të mos harrojmë se nga njëra anë jemi të gjithë partizanë (po i kthehem prapë debatit të NISA-s dhe nuk dua t'i hyj kësaj pjese) që mbajtja fizikisht e kësaj arkive, kudo që të jetë, ka një kosto. Kush do ta marrë këtë kosto dhe si do ta marrë, hajde ta diskutojmë. Problemi është, siç e tha edhe Tani, që në 5 vjetët e fundit, para se noteri të dalë në pension, t'i tërhiqet arkiva, sepse në momentet e fundit tenton... Praktikisht, po na ndodh që noteri del në pension dhe nuk e ka më...

**Ulsi Manja** – Është e qartë kjo situatë tani.

**Vasil Martini** – Për mua, digjitalizimi i arkivit është një akt që duhet rregulluar, ndoshta me ligj ose me Ministrinë e Drejtësisë.

**Ulsi Manja** – Problemet e arkivit do të gjejnë rregullim shterues në ligj, të jeni të bindur! Edhe draftin që kemi mbi tavolinë e kam parë. Në fakt, në përcaktimet që kemi bërë dhe në propozimet që janë bërë për arkivin, dispozitat më duken shumë të cekëta.

Do të ndërhyjmë fuqishëm te pjesa e rregullimit të arkivit. Unë e di që noteri që ka dalë në pension ose është në prag pensioni, as nuk do t'ia dijë për arkivin, por arkivat nuk mund të lihen rrugëve.

A do ta bëjmë nëpërmjet ligjit digjitalizimin e arkivave ekzistuese apo do të gjejnë një formë tjetër rregullimi se si do të bëhet ky digjitalizim? Kjo do të ngelet për t'u diskutuar në ditët në vazhdim, me EURALIUS-in dhe me dhomat e noterisë, sepse, në fund të fundit, 2-3 noterë e kanë bërë si iniciativë personale. Kjo ka kosto, ka kohë, ka edhe shpenzime, por do të gjejnë një mekanizëm si do ta zgjidhim.

**Vasilika Hysi** – Kam 2-3 pyetje.

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi, të lutem, bëji pyetjet dhe do ta mbyllim takimin!

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit!

Kam 2-3 meraqe te pjesa e veprimtarisë së noterëve.



Lexova procesverbalet e janarit të 2017-s dhe shumica e noterëve kishin kërkuar që ligji të merret më shumë me veprimtarinë e noterëve, aktet noteriale e të tjerë...

Kolegu Hysni Ahmetaj sugjeroi të kthehen të gjitha aktet që rregullon ligji i mëparshëm. Dua një opinion shumë të shkurtër me nga një fjali nga të gjithë ju. A jeni dakord ju, përfaqësuesit e dhomave vendore të noterëve, të kthehen aktet që rregullonte ligji i mëparshëm? (Ligji aktual, që është në fuqi, se e bëra sikur ka hyrë në fuqi ligji i ri).

Së dyti, dëshmia e trashëgimisë dhe shumë gjëra që janë në Kodin Civil janë kërkuar nga pjesa më e madhe e noterëve në tryezën e janarit të 2017-s, njëkohësisht, ka ardhur edhe me opinione individuale.

Unë kam një merak, që besoj se e kemi të gjithë. Si rregull, procedurat, rregullat, që rregullohen në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile, nuk është mirë të jenë në një ligj të thjeshtë. Shumica e noterëve mendonin që është më mirë ta kemi në konsideratë, se nuk ka asnjë gjë...

Nga ana tjetër, ligji nuk mund të bëhet Rregullore, sepse ju keni Dhomën Kombëtare të Noterisë, keni mbledhje, merrni vendime, rregulloni...

Do të doja opinionin tuaj, rregullimet në pjesën e posaçme, që kanë të bëjnë me substancën e punës suaj, a janë shumë të detajuara? A kanë nevojë të thjeshtohen dhe të zgjerohen? Nëse po, kur të depozitoni mendimin, ju lutem, të thoni se ky nen është i tepërt dhe sugjerojmë të mos jetë, sepse e ka Kodi Civil! Pra, ideja është që, meqenëse ka pasur mendime të ndryshme midis noterëve (e kuptoj që noterët me përvojë nuk kanë nevojë për rregulla specifike, noterët e rinj ndoshta, se unë nuk e di moshën e tyre) do të doja që te pjesa e përmbajtjes të përcaktoni që duhen përfshirë të gjitha aktet që rregullon ligji aktual në fuqi ose duhet të jenë 1,2,3 akte, sepse kemi shumë probleme me unifikimin e praktikave.

Doja të dija se cilat ishin ato probleme, për të cilat ju nuk keni gjetur kompromis ose nuk keni unifikuar praktika? Si mund të rregullohen ato?

Unë mendoj se jo çdo gjë mund të bëhet në ligj, por cilat mund të jenë çështjet më të rëndësishme, që kanë impakt në jetën e qytetarit, që mund të rregullohen në ligj dhe cilat do të lëmë për aktet nënligjore, që t'i rregullojmë nëpërmjet dispozitave kalimtare? Pra, ta autorizojmë Dhomën të bëjë aktet nënligjore, mundësisht edhe afatet, sepse unë nuk e di sa kohë do të duhet. Në qoftë se unë do t'ju them se duhen 3 muaj, mund t'ju marr më qafë, sepse unë nuk e di se sa i detajuar duhet të jetë. Ju jeni profesionistë dhe tani keni mbetur ata që... Kështu duhet ta kishim nisur debatin që në fillim.

Kam shumë merak për çështjet që lidhen me ripërsëritjen e Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile.

A jeni dakord ta pastrojmë ligjin, pra të mos përsërisim ato gjëra që janë në Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile dhe t'i lëmë aty? Nëse po, do t'ju lutesha, ashtu siç foli edhe zonja Hoxha, Agaraj, Radovani, konkretisht, të thoni se në këtë nen mendojmë se kjo është e tepër ose mund të ketë një dispozitë, që mund të jetë *blankete* dhe ta referojmë te dispozitat e Kodit Civil.

Kemi një diskutim (ju kërkoi ndjesë që nuk e thashë në fillim, kur ishin edhe përfaqësuesit e ministrisë) për të cilin ministria e Drejtësisë ka dhënë opinionin e saj, që është shumë i detajuar dhe vende-vende nuk përputhet, por kjo është e drejta e saj.

Nga ana tjetër, do të doja të dija opinionin tuaj për marrëdhënien mes bordit disiplinor dhe ministrit të Drejtësisë.

Nëse keni një opinion për mënyrën si është rregulluar, ju lutem, pasqyrojini me shkrim, por jo të thoni “kjo bën, kjo nuk bën” ose akuza të tilla “kush është kjo idiote që e ka shtuar” (se çfarë nuk kemi dëgjuar), “kush është kjo budallaçkë, kush ia ka dhënë diplomën” e të tjerë. Me këto do të futemi te Kodi i Etikës, kur të hyjë në fuqi ligji, se e kemi në *e-mail*-in zyrtar të Kuvendit dhe do të fillojmë me procedimin disiplinor. Do t'ju lutesha të flisni konkretisht se si mund të rregullohet. Këtë e kam për të gjithë ju që keni përvojë dhe vite në këtë punë.

E fundit lidhet me procedurën e shkollimit. Të gjithë kemi bërë pyetjen se përse duhet të ketë një periudhë kaq të gjatë. Sinqerisht, edhe unë ia kam bërë këtë pyetje misionit EURALIUS dhe më ka vënë në dispozicion standardet ndërkombëtare. Në një nga këto standarde ndërkombëtare, në pikën 5, neni 5, “Kushtet për të ushtruar noterinë”, thuhet se noteri duhet të ketë kualifikimin ligjor më të lartë në vend, të ketë Shkollën e Magjistraturës, të jetë mbi avokatin e të tjerë dhe shpjegon të gjitha procedurat. Pra, nenin 5/1, 5/2, 5/3 të standardeve, jemi të detyruar ta zbatojmë. Besoj se nuk do të kemi ndonjë tolerim shumë të madh.

Zoti Treska ngriti disa shqetësime për zëvendësnoterët. Zëvendësnoterët nuk jeni të detyruar t'i pranoni. Është alternativë.

I kam bërë një pyetje zonjës Sadushi para 1 viti e gjysmë (kemi qenë në një takim bashkë me zotin Xhafaj): Si i mbani njerëzit sot në zyra?

Unë e kam shtëpinë te Gjykata e Tiranës (e di Genta) dhe në çdo zyrë, unë, profesoresha dhe një pjesë e mirë, vijmë vërdallë të gjejmë noteren për t'i marrë vulën. Gjej studentet e mia që hartojnë çdo gjë dhe më thonë: “Profesoreshë, hajde në orën 09:00, se noterja ka shkuar në palestër”. Unë kam 12 zyra noterie ngjitur me shtëpinë time, por nuk gjej noterin. I kam të gjithë miq e mikësja, por nuk gjej noterë. Unë gjej studentë shumë të mirë, siç kam gjetur Lonën, që tani e kam komshie me zyrë. Kjo nuk shkon.

A mund t'i japim fund kësaj, që të mos marr "A-në" ose "B-në" dhe t'i them: "Kur do të jesh në zyrë"?

**Ulsi Manja** – Nëse do të marrësh, merr atë që e autorizon me ligj.

**Vasilika Hysi** – A mundemi t'i mbajmë këta njerëz?

A do t'u vinte mirë studentëve të ekselencës, që do të kalojnë këtë konkurs, t'i mbajmë në të zezë?

Për merakun e fundit që ka zoti Treska për familjarët, ne i kemi dhënë detyrë noterit të bëjë një vlerësim të zëvendësnoterit, që ai të konkurrojë.

A jeni në konflikt interesi, nëse ju do të merrni djalin ose vajzën dhe do t'i bëni vlerësimin, kur vlerësimi për zëvendësnoterin ka një peshë specifike, të konsiderueshme, te pikët?

Shikojeni se si mund ta zgjidhim këtë gjë, pa dëmtuar të drejtën e ushtrimit të lirë dhe zgjedhjes së profesionit. Besoj se askush nga ne nuk i lejon lidhjet nepotike, të marrësh vajzën apo djalin dhe ta vlerësosh.

**Ulsi Manja** – Dhe t'i japësh 30 pikë.

**Vaslika Hysi** – Dhe t'i japësh 30 pikë te vlerësimi i karrierës.

Ne kemi pasur një debat të gjerë midis asistentit dhe zëvendësnoterit.

Miqtë e mi, mendoni që jeni noterë dhe një ditë të bukur doni të pushoni 10 ditë apo 15 ditë ose mund të keni disa veprime, që mund t'ia lini një zëvendësnoteri, të cilin e keni të besuar. E mendoni këtë gjë? Shikojeni edhe këtë pjesë, gjithmonë, pa ju cenuar dhe riskuar. Në fund të fundit, jeni ju ata që do ta përcaktoni. Meraku im është se sa gjatë do të kemi në sistem zëvendësnoterë, deri sa të hapet një vend.

Të nderuar miq e kolegë,

Po flasim sot për noterët dhe arkivat, por deri më sot (e kundërshtoj atë që tha zoti Ahmetaj, le t'ia thotë zoti Treska) çdo ministër Drejtësie, nga 2012-ta e këtij, ditën kur ka ikur ka dhënë 55-65 licenca. Besoj se biem dakord që kjo gjë duhet të marrë fund.

Ne kemi akte, letra (do t'jua publikojmë), ku noterët na kanë shkruar si analafabetë. Nuk dinë të shkruajnë. Po të lexoni letrën drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, do të shikoni që janë analafabetë, shkruajnë pa pika, pa presje, pa germën ë dhe ç, pa kuptim. Të mos flasim pastaj për fjalët fyese dhe denigruese, për të cilat nuk e meritojnë të jenë noterë! Sinqerisht, nuk e meritojnë të jenë noterë! Mjerë kush i ka bërë dhe mjerë kush merr shërbime prej tyre!

Si munden ata të rregullojnë vetingun?! Ka pasur një ide për të bërë veting te ju.

Si mundemi ne ta vëmë në binarë sistemin, që të funksionojnë...?

Unë dhe kryetari e kemi shumë merak këtë.

**Ulsi Manja** – Më fal që po ndërhyj...!

**Vasilika Hysi** – E mbylla. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Nuk po i kthehem modës së vetingut për gjithçka, por në shërbimin e noterisë, ku ju folët për natyrën e veçantë që ka, duhet fuqizim i instrumenteve të inspektimit dhe të kontrollit. Këtë e kërkuat edhe ju sot, se si mund të fuqizohen inspektimet. Kaq.

Më lejoni t’ju jap vetëm disa shifra që m’i ka dhënë Dhoma dhe Ministria e Drejtësisë.

Në vitin 2011 kanë hyrë në sistem 33 noterë. Nuk di se çfarë studimi ka pasur për volumin, ngarkesën... Në 2012-n kanë hyrë 68 noterë në sistem. Në vitin 2013 kanë hyrë 57 noterë në sistem; në vitin 2014, 54 noterë; në vitin 2016 kanë hyrë 58 noterë në sistem dhe në janar të vitit 2017 kanë hyrë vetëm 3 noterë në sistem. Mbas janarit të 2017-s nuk ka më të dhëna. Po t’i mblidhni...

*(Diskutime pa mikrofon)*

“Në vitin 2017 nuk ka pasur konkurs, por rezultojnë të jenë regjistruar 3 noterë këtë vit”, kështu thuhet këtu.

**Mimoza Sadushi** – Mos është bërë transferim?

**Ulsi Manja** – Po, transferim, 1,2,3... Janë me emra.

Thotë: “Do të verifikohet nëse kanë qenë licenca të dhëna pas animimit të bërë për konkursin e dhjetorit të vitit 2016”, se mund të jenë anikimues...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk ka rëndësi kjo pjesë. A doni t’i heq edhe këto të tre? I heq unë këta të tre, po të doni ju heq edhe 10.

Po të bësh një mbledhje aritmetike të numrit total të noterëve në Shqipëri nga dita që është themeluar ky shërbim dhe të marrësh nga 470 noterë që ka Shqipëria (e kam numrin këtu dhe janë 470 noterë) se sa kanë hyrë pas vitit 2011, rezulton se kanë hyrë në sistem 250 noterë. Dakord?

Në Tiranë koeficienti i noterëve shkon 1 noter për 4900 banorë, ndërkohë që Korça ka koeficientin më të madh, me 1 noter për 27 mijë banorë. Pra, gjithë noterët i kanë kryet në Tiranë. Mbi 50 nga këta noterë, që e kanë licencën për ta ushtruar profesionin e noterit jashtë Tiranës, e ushtrojnë në Tiranë. Pse e them këtë? Sepse mungojnë mekanizmat dhe instrumentet e kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi këtë shërbim publik, që rrinë këta noterë në Tiranë, se po të kishim në ligj një mekanizëm të fortë të kontrollit dhe mbikëqyrjes, që për këto gjëra i penalizon noterët deri në heqjen e licencës, secili do të ishte duke e ushtruar profesionin në shtëpinë e vet, aty ku ka marrë licencën. Ky është shqetësimi që kemi. Prandaj po e diskutojmë dhe po e debatojmë shumë këtë ligj.

Më falni, por do t' u rikthehem edhe një herë komenteve që kanë ardhur!

Shumë nga noterët që na kanë sjellë komente, nuk e kanë kuptuar thelbin e projektligjit. Pse nuk e kanë kuptuar? Qëllimi i këtij projektligji nuk është të shtojë numrin e noterëve, por në një projektion të caktuar, të vijë drejt reduktimit numri i noterëve në Shqipëri, sepse Shqipëria, me të dhënat e INSTAT-it të janarit të vitit 2018, kur është bërë ky studim, është me 2,8 milionë banorë. Nëse në ligj do të vendosim koeficientin 1 noter për 10 mijë apo 15 mijë banorë, pjesëtojeni numrin dhe do të shihni se ku do të jetë projektioni për shërbimin e noterisë në Shqipëri, do të jetë 470-480 noterë apo do të jetë 200 noterë?

Por çfarë kemi bërë ne ose çfarë synohet me këtë ligj? Duke shtuar filtrat e hyrjes në sistem, ne mendojmë që në sistem të hyjë më i miri dhe sistemi me kalimin e kohës të bëjë pastrimin vet. Pastrimi, jo se duam ne, por sigurisht bëhet duke zbatuar rregullat dhe kërkesat e ligjit "Për noterinë". Ky është qëllimi i ligjit të noterisë.

Disa noterë na sugjerojnë se filtrat e vendosura në ligj kanë për qëllim të pamundësojnë futjen në sistemin e noterisë. Patjetër, rritja e filtrave kërkon futjen e profesionistëve në sistem dhe kur ju vetë e pranoni me gojën tuaj këtu në mbledhje që keni në radhët tuaja...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, mos e thuaj, nuk është nevoja, se CV-në ua kam marrë të gjithëve dhe i kam parë, pasi studimin e Ministrisë së Drejtësisë e kam këtu, por më lejoni t'jua them se edhe ju që jeni profesionistë nuk besoj se ndiheni komodë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Beni, ti mund ta thuash mendimin tënd, sepse je ndër noterët më të vjetër që ka Dhoma e Noterisë në Shkodër dhe unë kam punuar me ty.

Kjo është pak a shumë natyra e diskutimit që kishim sot dhe tani po ia kaloj fjalën Benit ta thotë edhe fjalën e tij, i cili ka 5 orë që është i pranishëm në mbledhje.

**Arben Koplaku** – Unë quhem Arben Koplaku, përfaqësues i Dhomës së Noterëve të Shkodrës.

Ju falënderoj për ftesën!

**Ulsi Manja** – Jeni edhe anëtar i Këshillit Kombëtar.

**Arben Koplaku** – Nuk jam anëtar i Këshillit Kombëtar, por diçka më lart.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në ligj u përmendën shumë gjëra si trashëgimia, anëtarët e familjes, ajo që tha Sabriu, që dëshminë e trashëgimisë duhet ta bëjë personi i interesuar. Këto të gjitha janë për faktin se kush i merr përsipër sanksionet që ka mosregjistrimi i vendimit të dëshmisë së trashëgimisë,

pasi personi i interesuar nuk është i interesuar që ta çojë punën deri në fund dhe të bëjë regjistrimin e kësaj dëshmie në Zyrën e Regjistrimit, pra, sipas mendimit tim, përveç vendimit që do të japë gjykata, shkresë apo urdhër, të përcaktohet edhe personi që do të bëjë regjistrimin e kësaj dëshmie, pasi kjo është e domosdoshme. Nuk po flas për funksionin e zëvendësnoterit, ku me të drejtë profesoresha thotë se nuk është i detyrueshëm.

**Vasilika Hysi** – Aty thuhet se mund të zgjedhë me kërkesë të noterit, po të dëshirojë...

**Arben Kopliku** – ... por në qoftë se vendoset unë mendoj se është jofunksional.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë nuk mund ta vendos nëse duhet apo jo, por për mendimin tim nuk duhet, jo se po më pyet njeri.

Po kthehem te vetingu. Të gjithë ata që do të bien nga fiku, përveç avokatisë, a thua do t'i turren edhe noterisë?

**Ulsi Manja** – Jo, e kemi ndaluar.

**Arben Kopliku** – Po i kthehem funksionit të noterit. Në shkresë nuk ishte e shkruar për kontratat, prokurat e pasurive të paluajtshme, por ato janë ndër më kryesoret, të cilat dëshirojmë t'i kemi...

**Vasilika Hysi** – Çfarë propozoni konkretisht?

**Arben Kopliku** – Unë mendoj se duhet shkruar se çfarë do të bëjë noteri. Ai zotëria e tha mirë, këtu ende nuk është shkruar se çfarë është noteri. Unë mendoj se kjo gjë duhet rregulluar më mirë, pasi nuk kam ndër mend të përsëris fjalët e të tjerëve, pasi kisha përgatitur diçka të vogël, të cilën jua kam nisur edhe me *e-mail*.

**Ulsi Manja** – Po, i kemi marrë.

**Arben Kopliku** - Unë mendoj se funksioni i zëvendësnoterit është i panevojshëm, por këto punë i dini ju më mirë.

Ju falënderoj për përkushtimin dhe kohën!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Kopliku!

Po, fjalën e ka kërkuar zonja Brati.

**Gentjana Brati** – Përshëndetje, i nderuar zoti kryetar!

E nderuara zonja Hysi,

Unë jam Gentjana Brati, anëtare e këshillit drejtues të Dhomës Kombëtare. Në vijim të asaj që tha profesoresha Hysi, për ndërhyrjet në ligjet e tjera, për të rregulluar edhe pjesën që i takon shitjes së apartamenteve që ato të mos shiten nga 2-3 herë në Tiranë dhe në Shqipëri të ndërhyhet në ligjin “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të vendoset një klauzolë ligjore që në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit dhe të zbardhjes nga Bashkia e Tiranës,

të bëhet regjistrimi me certifikate provizore, direkt në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me numër volumi dhe faqeje që unë si notere kur të më vij ndërtuesi për të shitur apartamentin “A” në objektin e banimit në rrugën “Sami Frashëri” të klikojë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të shikoj nëse është shitur nga Sonila apo nga Moza më parë, nuk është shitur, është bllokuar apo nuk është bllokuar. Ky është një problem shumë i madh, të cilin ne si noterë e hasim përditë, sepse njerëzit vijnë dhe përplasen te noteri. Sipas noterit, një pasuri nuk mund të shitet dhe të blihet në qoftë se nuk ka certifikatë pronësie dhe kjo për mendimin tim duhet të rregullohet në ligjin e pasurive të paluajtshme, por edhe për ligjin “Për noterinë”, ku të përcaktohet se cilat janë kontratat që bën noteri.

Një ndërhyrje tjetër është se të paktën sipas direktivave të BE-së, meqenëse ne si noterë e njohim shumë mirë praktikën noteriale europiane, shoqëritë tregtare krijohen në të gjithë Europën në prezencën e noterit, një nëpunës nuk mund të jetë i aftë i nëpunës i QKR-së apo i QKB-së të vlerësojë se si është akti i themelimit apo statuti për hartimin dhe funksionimin e një shoqërie tregtare, të cilat kanë të drejta dhe detyrime. Se si funksionon ligji, atë e di noteri dhe kjo është e rëndësishme që të bëhet në prezencën e noterit, prandaj sipas mendimit tim duhet të ndërhyhet edhe në ligjin e QKB-së dhe të rregullohet si funksion dhe t’i kalojë noterit siç ka qenë, pasi është noteri komponent dhe është po ai që e di se si funksionon një shoqëri tregtare. Kjo është praktika e shtetit italian, e shtetit francez, atij gjerman e kështu me radhë. Pra, për mendimin tim këto janë dy gjëra të rëndësishme, të cilat ne i prekim përditë. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Brati!

Po, zonja Hysi e ka fjalën.

**Vasilika Hysi** – Genta, a është e mundur që këto dy çështje që ju ngritët, të cilat edhe ne i kemi merak të zgjidhen? Pasi porosia e Kryeministrit është: a do të zgjidhet një herë e përgjithmonë shitja e pronave nga 20 herë?

Kjo është e vetmja gjë që ka kërkuar, ndërsa për të tjerat nuk ka ndërhyrë. A mund të bëni ju një propozim konkret që ta lidhni edhe me ligjin e QKB-së edhe me pasuritë e paluajtshme, meqenëse ky ligj do të vijë në parlament...?

**Gentjana Brati** – Kjo duhet të rregullohet patjetër...

**Vasilika Hysi** – Për sa kohë mund ta bëni?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vetëm zyrtarisht në adresën e komisionit.

**Ulsi Manja** – Besoj se nuk ka mendime të tjera. Të gjitha sa u thanë këtu duhet t’i sillni me shkrim, kush i ka me vete t’i dorëzojë tani në sekretari, kush i ka në rrugë elektronike, është

mirë që pasi të ktheheni nëpër zyrat tuaja të na i dërgoni edhe në rrugë elektronike. Ne i kemi mbledhur të gjitha sugjerimet dhe komentet e ardhura edhe nga noterët që ju keni nëpër Dhoma. Sipas mendimit tim, diskutimi që u bë këtu ishte një diskutim me vlerë, ky besoj është mendimi edhe i kolegëve të mi, të cilët dua t'i falënderoj për durimin, por edhe për kohën që i kushtuan kësaj tryeze, sepse është nga të paktat ligje, ku deputetët kanë ardhur dhe kanë qëndruar pothuajse deri në fund në një tryezë konsultimi për një projektligj siç është ai "Për noterinë".

Gjithashtu, dua t'ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen, ata që ishin në fillim, por e humbën durimin rrugës, ndoshta për shkak edhe të punës që kanë nëpër zyra, sepse ju sot keni mbyllur zyrat.

Ju falënderoj të gjithëve pa përjashtim!

Falënderoj përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, edhe pse sot ishin më tepër në rolin e dëgjuesit!

Falënderoj Agnesin, shefen e Misionit Euralius, sepse e kemi pjesë të punës sonë të pandarë në komisionin e Ligjeve, e cila është njeriu më dashamirës që ne kemi sot në mënyrë që Shqipëria të ketë ligje moderne, bashkëkohore në përputhje me legjislacionin e Bashkimit European!

Kjo tryezë shërbeu për të ofruar edhe qëndrimet e ndryshme brenda Dhomës Kombëtare të Noterisë, këtu po përfshij të gjitha dhomat vendore, por edhe noterë të caktuar. Që të ketë qëndrime të kundërta, kjo është krejtësisht normale, por ju duhet të afroheni për të pasur një qëndrim të përbashkët sa herë që bëhet fjalë për veprimtarinë noteriale. Sa i takon këtij projektligji, po të isha në rolin tuaj, do të kërkoja që 80% e përmbajtjes së këtij projektligji të ishte rregullimi i veprimtarisë noteriale. Kush është noteri? Cilat janë detyrat e noterit? Çfarë është akti noterial? Cili është veprimi juridik noterial? Si do të unifikohen praktikat dhe qëndrimet në ligj në lidhje me këto gjëra? Si do të shmanget konflikti i interesit në raport me palët që japin vullnetin në një akt noterial? Gjëja më e lehtë për të shmangur konfliktin e interesit në një zyrë noteriale është mes noterit dhe zëvendësnoterit apo fëmijëve të noterëve?

Pjesa tjetër e projektligjit që duhet të zërë pak vend, është mënyra e funksionimit dhe organizimit të noterisë. Si do të jetë e organizuar Dhoma? A do të ketë një asamble? A do të ketë një këshill drejtues? Këto nuk besoj se janë esenca e këtij projektligji, pasi këtu mund të merren modelet më të mira që ka Europa apo edhe traditën tonë, pasi janë bërë 28 vjet demokraci, ky shërbim tashmë është një shërbim i konsoliduar.



Pra, duhet të jeni ju ata që kërkonin ndryshimin e këtij ligji, jo ne. Shqipëria me reformën në drejtësi nuk kishte se si t'i linte jashtë vëmendjes shërbimet ligjore, ku përfshihet edhe noteria, sepse ato do të jenë pjesë e një sistemi të tërë në kuadrin e reformës në drejtësi. Nuk jam duke ju thënë se me projektligjin që do të miratojmë dhe do ta votojmë në Kuvend do të zgjidhim gjithçka. Jo. Për sa kohë që procesi i ligjvënësimit është një proces dinamik, sepse ligjet në Shqipëri ndryshojnë përditë, vetëm ligji i noterisë mund të ketë ndryshuar 2 apo 4 herë, ka ndryshuar Kodi Penal 19 herë, pasi hyri në fuqi në vitin 1995, ndërsa tani me Euraliusin i thuhet Stop, do të duhet Kodi i ri Penal.

Mos mendoni se sot me ligjin “Për noterinë” do t'i zgjidhim të gjitha, do të dalin shumë probleme në praktikë, por që të sistemojmë veprimtarinë noteriale, arkivat, aktet, përmbajtjen e akteve, të ndajmë qartësisht çfarë është e noterit është e noterit dhe çfarë nuk është e noterit nuk është e noterit. Në kuadrin e procesit të dixhitalizimit dhe të reformimit që po pësojnë institucionet shqiptare ju duhet të jeni kompakt dhe të mos i lëshoni kompetencat se janë gati t'ju marrin.

A doni t'ju jap një shembull? Është një shembull që e ka secili prej deputetëve. Unë jo më larg se sot, një kontratë shitblerjeje të mjetit tim ma ka sjellë Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor të Tiranës, kur e kam shitur dhe kur e kam blerë mjetin tim, në vitin 2007 dhe nuk kam nevojë të vijë të paguajë te ju. Pse? Sepse atje ku duhet ta dorëzojë aktin tim, te ILDKPI-ja mjafton nënshkrimi me vulën elektronike, se kush e ka emetuar atë dokument dhe merr vlerën zyrtare. Këtë e kam sot, jo më larg se sot...

**Vasilika Hysi** – Edhe Zyra e Hipotekës i ka të gjitha...

**Ulsi Manja** – Kjo vlen për të gjitha llojet e shërbimeve *online* që jep sot shteti shqiptar. Sot janë 1440 shërbime publike. Ne jemi në proces e sipër, deri tani gati 600-700 i japim *online*, por do të vijë një moment që 1400 shërbimet publike që shteti u ofron qytetarëve do të dixhitalizohen dhe do të bëhen *online*. Pse ju nuk doni të thoni që me këtë ligj, të rregullohet që çfarë është e noterit është jona se na e jep Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile dhe ligji i noterisë. Për gjëra që nuk janë esenciale, nuk keni pse të mos jeni kompakt. Gjithsecili prej jush në ushtrimin e funksionit është i lirë, e keni zgjedhur vetë, ashtu siç e kemi zgjedhur edhe ne, sepse nuk na ka lënë kush ta zgjedhim njëri-tjetrin. Ne kemi vetëm një gjë, mund të zgjedhim bashkëshortet tona, familjarët tanë, por komshiun nuk e zgjedhim dot, shokun patjetër mund ta zgjedhim, por komshiun dhe kolegun në profesion nuk mund ta zgjedhim dot.

Duke qenë se në dispozicion kemi 3 data deri sa të mbylлим sesionin parlamentar të vjeshtës. Është data 3 dhjetor, data 22 nëntor është seanca që kemi nesër. Kemi datat 3 dhjetor, 10 dhjetor dhe 20 dhjetor, në mos gaboj, janë tri seanca, nuk po llogaris datën 3, se është një

kohë shumë e afërt dhe do të na duhet edhe pak kohë t'i reflektojmë të gjitha qëndrimet, por datën 13 dhe 20 do t'ju lutesha të mos e humbisni, se, nëse nuk e zgjidhni këtë radhë, të jeni të bindur që nuk do të merret më kush me ju dhe me ligjin e noterisë dhe do të ngeleni kështu siç jeni.

Nga reforma në drejtësi, nga paketa e dytë prej 27 ligjesh, kemi vetëm 3 ligje në dorë: "Për noterinë", "Për përmbarrimin privat" dhe "Për Policinë Gjyqësore dhe strategjinë e edukimit ligjor", por Policia Gjyqësore është grupi i punës dhe institucionet që përfaqësojnë atë grup pune kanë gjetur pothuajse dakordësi. Përmbarrimin privat themi se do ta zgjidhim në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse, duke qenë se janë dy shërbime për afërsisht të ngjashme, po presim të ecim me noterinë që të ulemi e ta mbyllim edhe atë. Ju do të ngeleni pastaj kështu siç jeni, por edhe nëse doni të ngeleni siç jeni, ne nuk do t'ju lëmë, se është përgjegjësi politike jona rregullimi i këtij shërbimi në finale.

Dua ta mbyll me një fjalë që është diskutuar në tryezën e janarit ku thuhet: "Shtetin, që në rastin konkret me ju, e përfaqëson Ministria e Drejtësisë, ministri me reformën e re kushtetuese dhe ligjore në kuadrin e reformës në drejtësi. Ministri i Drejtësisë ka vetëm vullat e shtetit shqiptar. Përgjegjësinë sesi përdoren këto vula, qoftë në duart e privatit, apo në duart e publikut dhe respektimin e standardeve ligjore dhe kontrollin e këtyre standardeve në shërbim të publikut, e ka shteti", që në rastin konkret është ministri. Ne do të duam t'ju japim të gjithë tagrat që ju takojnë me ligj, por nuk mund të lëmë një shërbim ligjor shumë të rëndësishëm për qytetarin në një kaos të tillë.

Këtu e mbyll fjalën time duke ju falënderuar të gjithëve me radhë! Me një pjesë prej jush kam punuar dhe gëzoj respektin maksimal! Jeni ju zemra e noterisë, sepse kam përshtypjen, pa dashur të paragjykoj askënd, kush është bashkuar me ju vite më vonë, ose në këtë kohën e re, le të themi, kam përshtypjen do ta mësojë zanatin në rrugë e sipër duke punuar në zyrat e noterisë. Për një pjesë prej jush që e keni krijuar këtë shërbim, do të duhet t'ju dhimbset njëlloj siç keni njerëzit në shtëpi.

Faleminderit për durimin të gjithëve me radhë!

Në fundin e muajit nëntor drafti do të hyjë për diskutim në komision. Afati do të jetë 7 ditë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mblidhuni si të doni dhe shpërndahuni kur të doni! Ju mund të bëni edhe një mbledhje siç jeni këtu, në Pallatin e Kongreseve apo ku të doni me të 500 noterët e Shqipërisë. Ne duam që brenda datës 26, qoftë qëndrimet e dhomave, si dhoma me nënshkrimet e noterëve përkatës, qoftë qëndrimet individuale të secilit noter...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, dhomat vendore. Si do të na i përcillni? Dhoma e Durrësit: në rrugë elektronike 6 noterët të na përcjellin mendimet e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mendimet tuaja të unifikuara sillini brenda datës 26. 6-7 ditë janë mëse të mjaftueshme, pastaj pjesa tjetër i takon grupit të punës, zonjës Hysi, zonjës Bernhard, ekspertëve ndërkombëtare dhe vendas, si dhe kolegëve të mi të komisionit të japin përgjigjen përfundimtare.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**